


Plani Kombëtar i Veprimit për Personat LGBTI+ 2021-2027



**Periudha e
monitorimit:
Dhjetor 2021 -
Dhjetor 2025**

**Tiranë
Maj 2026**

Aleanca Kundër Diskriminimit LGBT



Autore: Ma. Sanela Lilaj; Av. LL.M Dea Nini

Aleanca Kundër Diskriminimit LGBT | Maj 2026



**Financuar nga
Bashkimi Evropian**

Ky botim u prodhua me mbështetjen financiare të Bashkimit Evropian. Përmbajtja e tij është përgjegjësi e vetme e autorit dhe nuk pasqyron domosdoshmërisht pikëpamjet e Bashkimit Evropian.



Gender Alliance for Development Center
Qendra Aleanca Gjinore për Zhvillim



ALEANCA KUNDËR DISKRIMINIMIT LGBT

RAPORT MONITORIMI

Plani Kombëtar i Veprimit për Personat LGBTI+ 2021-2027

Periudha e monitorimit: Dhjetor 2021 - Dhjetor 2025

Tiranë, Maj 2026

Përmbajtja e Raportit

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE	6
1. HYRJE	8
1.1 Baza ligjore dhe strategjike	9
1.2 Një Përmbledhje e Gjetjeve Kryesore të Monitorimit të PKV 2016-2020	10
2. METODOLOGJIA E MONITORIMIT	13
2.1 Burimet e informacionit	13
2.2 Shkalla e përgjigjes institucionale	14
2.3 Sistemi i vlerësimit	14
2.4 Kufizimet metodologjike	15
3. PLANI KOMBËTAR I VEPRIMIT 2021-2027: STRUKTURA, BUXHETI DHE LOGJIKA E NDËRHYRJES (ANEKSI 4)	16
3.1 Matrica e plotë e masave dhe aktiviteteve të planifikuara për zbatim (Aneksi 4)	17
4. GJETJET KRYESORE TË MONITORIMI	38
4.1 Panorama e përgjithshme e zbatimit	38
4.2 Pasqyra e vlerësimit të përgjithshëm të rezultateve të monitorimit sipas objektivave	39
5. ANALIZA E ZBATIMIT TË LOGJIKËS NDËRHYRËSE TË PKV-SË: INSTITUCIONET QENDRORE	43
5.1 Ministria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale (MSHMS)	43
5.1.1 Vlerësimi në raport me Aneksin 4	43
5.1.2 Vlerësimi i cilësisë së raportimit	44
5.2 Shërbimi Social Shtetëror (SHSSH)	45
5.2.1 Vlerësimi në raport me Aneksin 4	45
5.2.2 Vlerësimi i cilësisë së raportimit	46
5.3 Shkolla e Magjistraturës	47
5.3.1 Vlerësimi në raport me Aneksin 4	47
5.3.2 Vlerësimi i cilësisë së raportimit	48
5.4 Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas (DNJF)	48
5.4.1 Vlerësimi në raport me Aneksin 4	49
5.4.2 Vlerësimi i cilësisë së raportimit	50
5.5 Autoriteti i Mediave Audiovizive (AMA)	50
5.5.1 Vlerësimi në raport me Aneksin 4	51
5.5.2 Vlerësimi i cilësisë së raportimit	51
5.6 Ministria e Turizmit, Kulturës dhe Sportit (MTKS)	52
5.6.1 Vlerësimi në raport me Aneksin 4	53
5.6.2 Vlerësimi i cilësisë së raportimit	53
5.7 Ministria e Drejtësisë	54
5.7.1 Vlerësimi në raport me Aneksin 4	54
5.7.2 Vlerësimi i cilësisë së raportimit	55
5.8 Ministria e Financave	55
5.8.1 Vlerësimi në raport me Aneksin 4	56
5.8.2 Vlerësimi i cilësisë së raportimit	56
5.9 Institucionet e arsimit të lartë	56
5.9.1 Fakulteti i Shkencave Sociale, Universiteti i Tiranës	56
5.9.1.1 Vlerësimi në raport me Aneksin 4	57

5.9.1.2 Vlerësimi i cilësisë së raportimit.....	57
5.9.2 Fakulteti i Historisë dhe Filologjisë, Universiteti i Tiranës.....	58
5.9.2.1 Vlerësimi në raport me Aneksin 4	58
5.9.2.2 Vlerësimi i cilësisë së raportimit.....	59
5.9.3 Universiteti i Mjekësisë, Tiranë	59
5.9.3.1 Vlerësimi në raport me Aneksin 4	60
5.9.3.2 Vlerësimi i cilësisë së raportimit.....	61
5.10 Avokati i Popullit.....	61
5.10.1 Vlerësimi në raport me Aneksin 4	63
5.10.2 Vlerësimi i cilësisë së raportimit.....	63
6. ANALIZA E ZBATIMIT TË LOGJIKËS NDËRHYRËSE TË PKV-SË: NJËSITË E VETËQEVERISJES VENDORE.....	64
6.1 Gjetje të përgjithshme	64
6.2 Tabela e konsoliduar e gjetjeve të monitorimit në nivel vendor	65
7. KONTRIBUT MONITORUES NGA QENDRA STREHA	71
8. KONTRIBUT MONITORUES NGA ALEANCA KUNDËR DISKRIMINIMIT LGBTI	73
9. KONTRIBUT MBËSHTETËS NGA KËSHILLI I EVROPËS	77
10. PERSPEKTIVA E KOMUNITETIT LGBTI+	79
11. KONKLUZIONE TË MONITORIMIT	83
12. REKOMANDIME	84
BURIME DHE REFERENCA.....	88

LISTA E SHKURTESAVE

Shkurtesa	Kuptimi i plotë
AKPA	Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive
AKAFP	Agjencia Kombëtare e Arsimit dhe Formimit Profesional
AMA	Autoriteti i Mediave Audiovizive
AP	Avokati i Popullit
ASCAP	Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin Parauniversitar
ASPA	Shkolla Shqiptare e Administratës Publike
DNHJF	Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas
FHF	Fakulteti i Historisë dhe Filologjisë, Universiteti i Tiranës
FSHS	Fakulteti i Shkencave Sociale, Universiteti i Tiranës
IAL	Institucione të Arsimit të Lartë
IDAHOT	Dita Ndërkombëtare kundër Homofobisë, Transfobisë dhe Bifobisë
KMD	Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi
MAS	Ministria e Arsimit dhe Sportit
MB	Ministria e Brendshme
MD	Ministria e Drejtësisë
MFE	Ministria e Financave dhe Ekonomisë
MSHMS	Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale
MTKS	Ministria e Turizmit, Kulturës dhe Sportit
MKR	Mekanizmi i Koordinuar i Referimit
NBGJ	Nëpunës(e) i/e Barazisë Gjinore
NJMF	Njësia e Mbrojtjes së Fëmijëve
NJVV	Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore
NJVKSH	Njësia Vendore e Kujdesit Shëndetësor
OJF	Organizatë Jo-fitimprurëse
OMSA	Open Mind Spectrum Albania
OSHKSH	Operatori i Shërbimit të Kujdesit Shëndetësor
PKV	Plani Kombëtar i Veprimit
PSHSH	Policia e Shtetit Shqiptar
SOGI	Orientimi Seksual dhe Identiteti Gjinor
SHSSH	Shërbimi Social Shtetëror
SST	Sëmundje Seksualisht të Transmetueshme
UMT	Universiteti i Mjekësisë, Tiranë
VKM	Vendim i Këshillit të Ministrave
ZVP	Zyra Vendore e Punësimit

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Ky raport monitorimi synon të vlerësojë në mënyrë objektive nivelin e zbatimit të Planit Kombëtar të Veprimit për Personat LGBTI+ 2021-2027 (PKV) gjatë periudhës Janar 2021 - Dhjetor 2025, duke mbuluar pesë vitet e para të zbatimit nga shtatë të planifikuara. Monitorimi është realizuar nga Aleanca Kundër Diskriminimit LGBTI mbi bazën e kërkesave zyrtare për informacion drejtuar institucioneve përgjegjëse, në përputhje me logjikën e ndërhyrjes të përcaktuar në Aneksin 4 të PKV-së, analizës doktrinare, si dhe të dhënave të mbledhura përmes pyetësorëve të zhvilluar gjatë pesë viteve të fundit me individë të komunitetit LGBTI+ në Shqipëri.

Gjetjet kryesore të këtij monitorimi tregojnë se zbatimi aktual i PKV-së mbetet i ulët, i pjesshëm dhe i pabarabartë ndërmjet sektorëve dhe niveleve qeverisëse të institucioneve përgjegjëse sipas Aneksit 4. Progresi në zbatimin e këtij dokumenti strategjik është dokumentuar vetëm në ato raste ku ekzistojnë prova konkrete, të mbështetura në të dhëna dhe rezultate të verifikueshme.

Megjithëse evidentohet një nivel i kufizuar progresi, veçanërisht në drejtim të trajnimit të stafit të institucioneve të drejtësisë, mbështetjes financiare për Qendrën Streha dhe aktivitetit të raportuar nga Avokati i Popullit, ky progres mbetet i paqëndrueshëm dhe në masë të konsiderueshme i mbështetur në kontributin e shoqërisë civile dhe donatorëve ndërkombëtarë, më shumë sesa në angazhimin e drejtpërdrejtë institucional.

Pesë gjetje kritike të këtij monitorimi janë:

- Mbi 83% e bashkive të kontaktuara mes kërkesave zyrtare për informim nuk kanë kthyer asnjë përgjigje brenda afatit ligjor, tregues alarmi mbi nivelin e transparencës dhe llogaridhënies institucionale në nivel vendor.
- Asnjë bashki, nga ato që kthyen përgjigje, nuk raporton një buxhet të dedikuar për zbatimin e PKV-së.
- Shumica e aktiviteteve të raportuara si të zbatuara nga institucionet publike janë organizuar ose financuar nga shoqëria civile dhe donatorët ndërkombëtarë, ku institucioni raportues ka pasur rol kryesisht mbështetës.
- Produktet kryesore të Aneksit 4, duke përfshirë protokollet mjekësore, modulet e formalizuara kurrikulare, pikat fokale LGBTI+ në strukturat vendore dhe mekanizmat e referimit, mbeten kryesisht të paprovuara si të zbatuara.

- **Perspektiva e komunitetit LGBTI+, e parë si e lidhur me objektivat e PKV-së, tregon një përkeqësim të disa treguesve kryesorë: dëshira për emigrim u rrit nga 65% (2020-2024) në 82.2% (2024-2025); pasiguria në strehim u rrit nga 42% në 48.7%; diskriminimi në shëndetësi u rrit nga 22% në 26.9%.**

Ky raport, synon të shërbejë si një mjet transparence lidhur me nivelin e zbatimit të PKV-së, por edhe si një mjet mbështetës për institucionet kombëtare në drejtim të arritjes së barazisë thelbësore dhe përmirësimit të jetës së personave LGBTI+ në Shqipëri. Në këtë kuadër, raporti ofron rekomandime konkrete për periudhën e mbetur të zbatimit 2026-2027, me fokus në operacionalizimin e masave të pazbatuara, sigurimin e financimit të dedikuar dhe forcimin e mekanizmave të monitorimit.

1. HYRJE

Plani Kombëtar i Veprimit për Personat LGBTI+ 2021-2027, i miratuar me Vendimin e Këshillit të Ministrave (VKM) Nr. 700, datë 18.11.2021, përbën dokumentin kryesor strategjik të Qeverisë Shqiptare për mbrojtjen, promovimin dhe avancimin e të drejtave të personave LGBTI+ në Shqipëri, për një periudhë shtatëvjeçare.

Ky dokument strategjik ndërtohet mbi tre qëllime të politikave publike, të formuluara si vijon:

- (i) Përmirësimi i aksesit të personave LGBTI+ në shërbime publike cilësore dhe në shërbime mbështetëse të specializuara, të disponueshme në të gjithë territorin e vendit dhe në përputhje me nevojat e tyre specifike;
- (ii) Garantimi i mbrojtjes efektive dhe sigurisë për personat LGBTI+ nëpërmjet përmirësimit dhe zbatimit të kuadrit ligjor, forcimit të mekanizmave institucionalë dhe rritjes së aksesit në sistemin e drejtësisë;
- (iii) Krijimi dhe promovimi i një shoqërie gjithëpërfshirëse, të barabartë dhe jodiskriminuese, përmes rritjes së ndërgjegjësimit publik, luftimit të stereotipeve dhe paragjyqimeve, si dhe fuqizimit të pjesëmarrjes së personave LGBTI+ në jetën sociale, ekonomike dhe publike.

Detyrimet specifike të secilit institucion publik janë të parashikuara në Aneksin 4 të Planit, ku detajohet logjika e ndërhyrjes institucionale, përfshirë objektivat specifike, masat konkrete, afatet kohore dhe institucionet përgjegjëse për zbatimin e tyre.

Ky raport monitorimi synon që në mënyrë të plotë dhe të strukturuar:

- (i) Të identifikojë nivelin real dhe aktual të zbatimit të secilit objektiv të politikave, objektivave specifike, masave dhe aktiviteteve të parashikuara në Planin Kombëtar të Veprimit për Personat LGBTI+ 2021-2027, në përputhje me logjikën e ndërhyrjes të përcaktuar në Aneksin 4;
- (ii) Të vlerësojë në mënyrë kritike progresin e institucioneve përgjegjëse në raport me detyrimet e tyre institucionale, duke u bazuar në të dhëna konkrete, të verifikueshme dhe të matshme;
- (iii) Të evidentojë në mënyrë të detajuar sfidat, boshllëqet strukturore, vonesat në zbatim dhe mungesën e përputhjes ndërmjet masave të planifikuara dhe rezultateve të raportuara;

- (iv) Të analizojë nivelin e koordinimit ndërinstitucional dhe funksionimin e mekanizmave të parashikuar për zbatimin, raportimin dhe monitorimin e Planit; dhe
- (v) Të ofrojë rekomandime konkrete, të zbatueshme dhe të orientuara drejt rezultateve për periudhën e mbetur të zbatimit 2026-2027, me fokus në operacionalizimin efektiv të masave të pazbatuara, sigurimin e burimeve të mjaftueshme financiare dhe forcimin e mekanizmave të monitorimit dhe llogaridhënies.

1.1 Baza ligjore dhe strategjike

Monitorimi i realizuar në kuadër të këtij raporti mbështetet në kuadrin kushtetues, ligjor dhe strategjik në fuqi në Republikën e Shqipërisë, si dhe në standardet dhe angazhimet ndërkombëtare të shtetit shqiptar në fushën e të drejtave të njeriut dhe mosdiskriminimit.

Në nivel kushtetues dhe ligjor, analiza mbështetet në:

- (i) **Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë**, veçanërisht nenin 18, i cili garanton parimin e barazisë përpara ligjit dhe ndalon diskriminimin;
- (ii) **Ligjin Nr. 10221/2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”**, i ndryshuar, i cili njeh shprehimisht orientimin seksual, identitetin gjinor dhe karakteristikat e seksit si shkaqe të mbrojtura dhe përbën instrumentin kryesor për garantimin e parimit të mosdiskriminimit në nivel kombëtar;
- (iii) **Kodin Penal të Republikës së Shqipërisë**, që parashikon sanksione për veprat penale të motivuara nga urrejtja dhe diskriminimi;
- (iv) **Kodin e Punës**, i cili ndalon diskriminimin në marrëdhëniet e punës, përfshirë për shkaqe që lidhen me orientimin seksual dhe identitetin gjinor;
- (v) **Ligjin Nr. 111/2017 “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti”**, që garanton akses në drejtësi për viktimat e diskriminimit;
- (vi) **Ligjin Nr. 22/2018 “Për strehimin social”**, i ndryshuar, i cili parashikon masa mbrojtëse për individët në nevojë, përfshirë personat LGBTI+ në situata vulnerabël;
- (vii) **Ligjin Nr. 10107/2009 “Për kujdesin shëndetësor në Republikën e Shqipërisë”**, i ndryshuar, që garanton akses universal në shërbimet shëndetësore;
- (viii) **Ligjin Nr. 10/2021 “Për azilin në Republikën e Shqipërisë”**, i cili njeh personat LGBTI+ si kategori të veçantë në nevojë për mbrojtje ndërkombëtare në raste përndjekjeje; si dhe,

(ix) **Ligjin Nr. 10129/2009 “Për gjendjen civile”**, i ndryshuar, i cili rregullon aspektet procedurale që lidhen me përbërësit e gjendjes civile dhe ndryshimet e tyre në dokumentacionin zyrtar.

Në nivel strategjik, ky raport monitorimi lidhet dhe analizon zbatimin e PKV-së në përputhje me dokumentet kryesore strategjike kombëtare dhe ndërkombëtare, përfshirë:

- **Strategjinë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim Evropian 2022-2030;**
- **Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm (OZhQ) dhe Axhendën 2030 të Organizatës së Kombeve të Bashkuara;** si dhe,
- **Strategjitë e Komisionit Evropian “Strategjia për Barazinë LGBTIQ 2020-2025” dhe “Strategjia për Barazinë LGBTIQ 2026-2030”,** që përbëjnë një kornizë referimi lidhur me harmonizimin e politikave kombëtare me standardet e Bashkimit Evropian, në kuadër të procesit euro-integrues.

1.2 Një Përmbledhje e Gjetjeve Kryesore të Monitorimit të PKV 2016-2020

Raporti i Vlerësimit të Planit Kombëtar të Veprimit për Personat LGBTI 2016-2020, i përgatitur në emër të Qeverisë së Republikës së Shqipërisë nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, përmes strukturave përgjegjëse për politikën e përfshirjes sociale dhe barazisë gjinore, me mbështetjen dhe ekspertizën teknike të Këshillit të Evropës, përbën dokumentin kryesor institucional për analizimin e nivelit të zbatimit të planit pararendës dhe një pikë reference thelbësore për vlerësimin e progresit dhe mangësive strukturore në këtë fushë.

Në terma të përgjithshëm, raporti monitorues për PKV pararendës, konstaton se periudha 2016-2020 ka shënuar përmirësime të ndjeshme në situatën e personave LGBTI në Shqipëri, veçanërisht në drejtim të rritjes së vizibilitetit publik, forcimit të dialogut institucional dhe zhvillimit të aktiviteteve ndërgjegjësuese. Megjithatë, këto përmirësime rezultojnë të jenë të pabarabarta dhe të përqendruara kryesisht në Tiranë, duke lënë pas zonat jashtë kryeqytetit dhe grupet më të cenueshme, si personat transgjinorë dhe interseks, të cilët kanë përfituar në mënyrë shumë më të kufizuar nga progresi i raportuar.

Një nga gjetjet më të rëndësishme të këtij vlerësimi lidhet me hendekun midis planifikimit dhe zbatimit efektiv të masave të planifikuara. Edhe pse PKV 2016-2020 përmbante objektiva dhe indikatorë të matshëm për një pjesë të konsiderueshme të aktiviteteve, raporti

evidenton se për shumë prej tyre mungonin të dhënat mbi nivelin real të zbatimit, për shkak të mungesës së mekanizmave funksionalë të mbledhjes dhe raportimit të të dhënave. Ky deficit në monitorim dhe vlerësim përbënte një nga dobësitë më të theksuara strukturore të planit.

Në aspektin institucional, raporti i monitorimit thekson se niveli i angazhimit të institucioneve përgjegjëse ka qenë i pabarabartë, me disa sektorë, si Policia e Shtetit, që kanë shënuar progres të matshëm në drejtim të trajtimit të krimeve të urrejtjes dhe bashkëpunimit me komunitetin, ndërsa në fusha të tjera institucionet kanë ndërmarrë pak ose aspak masa konkrete për zbatim. Kjo situatë lidhej drejtpërdrejt me mungesën e burimeve njerëzore dhe financiare, si dhe me nivelin e ulët të prioritizimit të çështjeve LGBTI në politikat publike.

Një tjetër gjetje thelbësore lidhur me nivelin e zbatimit të PKV pararendës, lidhet me financimin e pamjaftueshëm të tij. Raporti evidenton se burimet financiare të alokuara për zbatimin e PKV 2016-2020 nuk kanë qenë në përputhje me objektivat dhe masat e parashikuara, duke bërë që një pjesë e konsiderueshme e aktiviteteve të realizohej falë mbështetjes së organizatave të shoqërisë civile dhe donatorëve ndërkombëtarë, të cilët kanë luajtur një rol kyç në implementimin praktik të planit.

Në nivel sektorial, vlerësimi evidenton mangësi të theksuara në disa fusha kyçe:

- (i) Punësimi, ku mungojnë politika dhe masa konkrete për përfshirjen e personave LGBTI në tregun e punës;
- (ii) Arsimi, ku çështjet LGBTI mbeten të nën-përfaqësuara në kurrikula dhe në trajnimet e mësuesve;
- (iii) Shëndetësia, ku, pavarësisht disa hapave fillestarë, vazhdojnë të ekzistojnë barrierat në akses dhe mungesë e shërbimeve të specializuara, veçanërisht për personat transgjinjorë;
- (iv) Strehimi, ku progresi mbetet i kufizuar dhe kryesisht i lidhur me iniciativat të mbështetura nga shoqëria civile, si Qendra “Streha”.

Në aspektin ligjor, raporti identifikon disa zhvillime pozitive, përfshirë përmirësime në kuadrin ligjor për ndihmën juridike dhe strehimin social, por njëkohësisht evidenton boshllëqe të rëndësishme ligjore, si mungesa e një kuadri të qartë për njohjen ligjore të identitetit gjinor dhe nevoja për ndryshime në Kodin e Familjes dhe akte të tjera relevante.

Një dimension tjetër kritik lidhet me nivelin e diskriminimit dhe qëndrimet shoqërore, të cilat vazhdojnë të mbeten problematike, veçanërisht jashtë Tiranës. Pavarësisht progresit në ndërgjegjësim, personat LGBTI përballen ende me diskriminim të përhapur, gjuhë urrejtjeje dhe forma të ndryshme të dhunës, ndërsa mekanizmat institucionalë për adresimin e këtyre fenomeneve mbeten të dobët dhe të fragmentuar.

Në përfundim, raporti i vlerësimit të PKV 2016-2020 nxjerr në pah një kontrast të qartë ndërmjet zhvillimit të një kornize politike relativisht të avancuar dhe mungesës së zbatimit të qëndrueshëm në praktikë, i cili ka rezultuar i fragmentuar, i nënfinancuar dhe në masë të konsiderueshme i varur nga aktorë jo-shtetërorë.

Për këtë arsye, rekomandimet kryesore të raportit fokusohen në:

- (i) forcimin e mekanizmave të monitorimit dhe mbledhjes së të dhënave;
- (ii) sigurimin e burimeve të mjaftueshme financiare dhe njerëzore;
- (iii) rritjen e përgjegjshmërisë dhe përfshirjes së institucioneve në zbatim; dhe
- (iv) zgjerimin e ndërhyrjeve përtej kryeqytetit, me fokus të veçantë tek grupet më të cenueshme.

Këto gjetje dhe mësimet të nxjerra përbëjnë një bazë thelbësore për analizimin e zbatimit të Planit Kombëtar të Veprimit 2021-2027, duke ofruar një kornizë krahasuese për të vlerësuar nëse mangësitë strukturore të identifikuara në planin pararendës janë adresuar në mënyrë efektive në fazën aktuale të zbatimit.

2. METODOLOGJIA E MONITORIMIT

Metodologjia e këtij raporti synon të paraqesë një vlerësim sa më të plotë, të besueshëm dhe të bazuar në prova mbi nivelin e zbatimit të Planit Kombëtar të Veprimit për Personat LGBTI+ 2021-2027.

Për këtë qëllim, është ndjekur një qasje e kombinuar metodologjike, e cila ndërthur analiza cilësore dhe sasiore, duke integruar burime të ndryshme informacioni dhe duke mundësuar një vlerësim faktual të progresit institucional dhe të ndikimit të këtij dokumenti strategjik në praktikë.

2.1 Burimet e informacionit

Monitorimi është mbështetur në një sërë burimesh informacioni, të cilat janë përdorur në mënyrë plotësuese për të siguruar një analizë të balancuar dhe të verifikueshme.

Së pari, është realizuar një analizë e thelluar dokumentare (desk research), e cila ka përfshirë shqyrtimin e dokumenteve ligjore dhe nënligjore në fuqi, dokumenteve strategjike relevante, raporteve kombëtare dhe ndërkombëtare, akteve institucionale, statistikave administrative, si dhe raporteve të Komisionit Evropian dhe mekanizmave ndërkombëtarë të të drejtave të njeriut.

Së dyti, janë dërguar kërkesa zyrtare për informacion ndaj 17 institucioneve qendrore dhe 61 bashkive, në përputhje me Ligjin nr. 119/2014 “Për të Drejtën e Informimit”. Institucionet janë ftuar të raportojnë në mënyrë të strukturuar mbi katër dimensione kryesore: veprimet e ndërmarra në kuadër të zbatimit të Planit, afatet dhe planet për implementim, burimet financiare të përdorura, si dhe vështirësitë e hasura gjatë procesit të zbatimit.

Së treti, analiza është mbështetur në të dhëna të siguruar nga organizatat e shoqërisë civile, përfshirë informacionin e vënë në dispozicion nga Qendra Streha mbi shërbimet e ofruara, trajnimet e zhvilluara dhe burimet financiare të përdorura. Gjithashtu, janë marrë në konsideratë të dhëna mbi aktivitetet e mbështetura ose të realizuara gjatë periudhës së raportimit nga organizata të ndryshme, megjithëse duhet theksuar se vetëm një numër i kufizuar organizatash kanë ofruar informacion të strukturuar dhe të verifikueshëm.

Së katërti, një komponent i rëndësishëm i analizës përbëhet nga të dhënat e mbledhura përmes pyetësorëve me komunitetin LGBTI+. Konkretisht, janë përdorur gjetjet e pyetësorit kombëtar të realizuar nga Aleanca Kundër Diskriminimit LGBTI gjatë periudhës 2021-2025

me një kampion vjetor rreth 150 persona LGBTI+, të cilat ofrojnë perspektivën e drejtpërdrejtë të komunitetit LGBTI+. Kjo qasje ka mundësuar identifikimin e trendeve në kohë dhe krahasimin e gjendjes aktuale me periudhat e mëparshme raportuese, duke e vendosur analizën në një dimension dinamik dhe jo vetëm statik.

2.2 Shkalla e përgjigjes institucionale

Në kuadër të kërkesave për informacion të dërguara për qëllimet e këtij monitorimi, përgjigje janë marrë nga një numër institucionesh qendrore dhe aktorësh të tjerë, përfshirë Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Shërbimin Social Shtetëror, Ministrinë e Financave, Ministrinë e Drejtësisë, Ministrinë e Turizmit, Kulturës dhe Sportit, Autoritetin e Mediave Audiovizive, Drejtorinë e Ndhmës Juridike Falas, Shkollën e Magjistraturës, Universitetin e Mjekësisë Tiranë, Fakultetin e Shkencave Sociale, Fakultetin e Historisë dhe Filologjisë dhe Avokatin e Popullit. Po kështu, në nivel vendor, përgjigje janë marrë nga nëntë bashki, konkretisht bashkitë Shkodër, Lezhë, Kuçovë, Elbasan, Mallakastër, Peqin, Belsh, Vorë dhe Himarë.

Nga ana tjetër, një numër i konsiderueshëm institucionesh nuk kanë kthyer përgjigje, përfshirë Komisionerin për Mbrojtjen nga Diskriminimi, Agjencinë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive, Ministrinë e Punëve të Brendshme, Shërbimin Kombëtar të Punësimit, Akademinë e Sigurisë, Fakultetin e Drejtësisë dhe Agjencinë e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin Parauniversitar, si dhe 52 bashki.

Mungesa masive e përgjigjeve, veçanërisht në nivel vendor dhe nga disa institucione kyçe në nivel qendror dhe të pavarura, nuk trajtohet vetëm si kufizim metodologjik, por përbën një gjetje kyçe të monitorimit, e cila reflekton nivel të ulët transparence, mungesë të mekanizmave funksionale të raportimit dhe përgjegjshmëri të kufizuar institucionale në lidhje me zbatimin e Planit.

2.3 Sistemi i vlerësimit

Vlerësimi i nivelit të zbatimit të logjikës ndërhyrëse të PKV-së është realizuar përmes një sistemi të kombinuar, i cili integron një shkallë cilësore vlerësimi me analizën e drejtimit të progresit.

Shkalla cilësore me katër nivele përdoret për të vlerësuar nivelin e provueshëm të zbatimit, duke u bazuar në ekzistencën e provave konkrete, produkteve të formalizuara dhe të

dhënave të matshme. Në këtë kuadër, një masë konsiderohet e pazbatuar kur nuk evidentohet asnjë aktivitet apo produkt i zbatimit; minimalisht e zbatuar kur ekzistojnë vetëm përpjekje fillestare për zbatim, pa rezultate të qarta; pjesërisht e zbatuar kur ka produkte të matshme nga zbatimi, por ndërhyrja mbetet e paplotë, dhe plotësisht e zbatuar kur të gjitha aktivitetet dhe produktet e planifikuara janë realizuar në përputhje me treguesit dhe afatet e paracaktuara.

NIVELI	KUPTIMI
I pazbatuar	Asnjë aktivitet ose produkt i Aneksit 4 nuk provohet i zbatuar.
Minimalisht i zbatuar	Disa aktivitete të filluara, por produktet kryesore të Aneksit 4 mungojnë ose janë të paplotësuara.
Pjesërisht i zbatuar	Produkte të matshme ekzistojnë, por zbatimi është i paplotë ose jo i vazhdueshëm ndaj treguesve.
Plotësisht i zbatuar	Të gjitha aktivitetet dhe produktet e Aneksit 4 janë realizuar sipas afateve dhe treguesve.

Paralelisht, drejtimi i progresit (↑ ↔ ↓), përdoret për të vlerësuar ndryshimin e treguesve në kohë, duke identifikuar nëse situata ka shënuar përmirësim, ka mbetur e pandryshuar apo ka pësuar regres në raport me gjendjen bazë dhe objektivat e Planit.

DREJTIMI	KUPTIMI
↑	Progres i evidentueshëm ndaj gjendjes bazë
↔	Pa ndryshim të rëndësishëm
↓	Përkeqësim i treguesve
-	Nuk aplikohet ose pa të dhëna krahasuese

2.4 Kufizimet metodologjike

Monitorimi u përball me disa kufizime metodologjike. Së pari, shumica e përgjigjeve institucionale rezultuan të jenë narrative dhe të përgjithshme, pa mbështetje në statistika apo dokumentacion të verifikueshëm. Së dyti, në shumë raste mungon një ndarje e qartë ndërmjet aktiviteteve të zbatuara nga vetë institucionet dhe atyre të organizuara nga organizatat e shoqërisë civile ose donatorët ndërkombëtarë.

Një tjetër kufizim i rëndësishëm lidhet me mungesën e një sistemi të unifikuar shtetëror për mbledhjen dhe raportimin e të dhënave të ndara sipas orientimit seksual, identitetit gjinor dhe karakteristikave të seksit, çka kufizon mundësinë për një analizë të saktë dhe të krahasueshme ndërmjet sektorëve.

Gjithashtu, niveli i ulët i përgjigjes nga institucionet, veçanërisht në nivel vendor, kufizon shtrirjen e analizës dhe evidenton mangësi në transparencë dhe llogaridhënien publike.

Në këtë kontekst, mungesa e provës së zbatimit në rastet kur nuk paraqitet dokumentacion mbështetës nuk është trajtuar vetëm si kufizim metodologjik, por si një tregues i kapacitetit të dobët institucional dhe i mungesës së mekanizmave efektive të raportimit dhe monitorimit.

3. PLANI KOMBËTAR I VEPRIMIT 2021-2027: STRUKTURA, BUXHETI DHE LOGJIKA E NDËRHYRJES (ANEKSI 4)

Plani Kombëtar i Veprimit për Personat LGBTI+ 2021-2027 ndërtohet mbi një kornizë të strukturuar të ndërhyrjes, e cila përfshin tre qëllime të politikave publike, objektiva specifike, rezultate të arritshme, tregues të matshëm dhe masa konkrete zbatimi, të detajuara në Aneksin 4 të Planit. Kjo strukturë përbën bazën kryesore për monitorimin dhe vlerësimin e progresit institucional, duke mundësuar lidhjen e drejtpërdrejtë ndërmjet aktiviteteve të parashikuara për zbatim, atyre të realizuara, produkteve të pritshme dhe rezultateve të synuara.

Plani ndërtohet mbi tre qëllime kryesore të politikave publike:

- (i) përmirësimi i aksesit të personave LGBTI+ në shërbime publike dhe mbështetëse të specializuara (Objektivat specifike I.1-I.4);
- (ii) përforcimi i mbrojtjes ligjore dhe garantimi i aksesit në drejtësi (Objektivat specifike II.1-II.2); dhe
- (iii) promovimi i një shoqërie gjithëpërfshirëse dhe jodiskriminuese (Objektivat specifike III.1-III.2).

Koordinimi i përgjithshëm i zbatimit të Planit i është ngarkuar Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, në bashkëpunim me ministritë e linjës, institucionet e pavarura dhe njësitë e vetëqeverisjes vendore. Në këtë kuadër, bashkëpunimi ndërinstitucional, si në nivel horizontal ashtu edhe vertikal, përbën një kusht thelbësor për funksionimin efektiv të logjikës së ndërhyrjes dhe për përmbushjen e treguesve të Planit.

Buxheti total i planifikuar për zbatimin e Planit është parashikuar 351,909,255 lekë (rreth 2.84 milionë euro), nga të cilat 62.3% parashikohet të mbulohet nga buxheti i shtetit, 17.2% nga financimi i huaj, ndërsa 20.5% përbën hendek financiar të pambuluar. Kjo strukturë financiare tregon se zbatimi i Planit mbështetet në mënyrë të konsiderueshme në burime të jashtme dhe mbetet pjesërisht i pa buxhetuar, çka paraqet rrezik për realizimin e plotë të masave të parashikuara.

3.1 Matrica e plotë e masave dhe aktiviteteve të planifikuara për zbatim (Aneksi 4)

Në përputhje me logjikën e Aneksit 4, çdo qëllim i politikave publike operacionalizohet përmes një zinxhiri të qartë ndërhyrjeje, i cili lidh masat konkrete me rezultatet e arritshme dhe treguesit e matshëm. Në këtë kuptim, vlerësimi i zbatimit kërkon jo vetëm identifikimin e aktiviteteve të ndërmarra, por verifikimin e përmbushjes së rezultateve dhe treguesve përkatës.

Në kuadër të Qëllimit të Politikës I (Aksesi në Shërbime), Plani synon rritjen e aksesit në shërbime të specializuara, përmirësimin e cilësisë së tyre dhe fuqizimin e kapaciteteve të profesionistëve në sektorët e shërbimeve sociale, arsimit, shëndetësisë dhe punësimit. Rezultatet e arritshme përfshijnë rritjen e numrit të përfituesve të shërbimeve, përmirësimin e standardeve të tyre dhe zgjerimin e përfshirjes së personave LGBTI+ në sistemet publike. Këto rezultate maten përmes treguesve të tillë si numri i shërbimeve të përmirësuara, përqindja e buxhetit të alokuar për to, numri i profesionistëve të trajnuar dhe numri i përfituesve në programe mbështetëse.

Në kuadër të Qëllimit të Politikës II (Mbrojtja Ligjore dhe Drejtësia), Plani synon përmirësimin e kuadrit ligjor dhe forcimin e mekanizmave institucionalë për adresimin e diskriminimit dhe dhunës. Rezultatet e arritshme përfshijnë harmonizimin e legjisllacionit me standardet ndërkombëtare, rritjen e aksesit në drejtësi dhe përmirësimin e kapaciteteve të institucioneve të drejtësisë dhe policisë. Treguesit përkatës përfshijnë numrin e rasteve të trajtuara, numrin e ndryshimeve ligjore të miratuara, ekzistencën e raporteve mbi diskriminimin dhe funksionimin e pikave fokale në polici.

Në kuadër të Qëllimit të Politikës III (Shoqëria Gjithëpërfshirëse), Plani fokusohet në ndryshimin e qëndrimeve shoqërore dhe promovimin e një mjedisi jodiskriminues. Rezultatet e arritshme përfshijnë rritjen e nivelit të pranimit social dhe reduktimin e stereotipeve ndaj personave LGBTI+, ndërsa treguesit përkatës maten përmes perceptimit të komunitetit

LGBTI+, qëndrimeve të të rinjve dhe përfshirjes së punëdhënësve në iniciativa të gjithëpërfshirjes.

Në tërësi, struktura e Aneksit 4 përfaqëson një kornizë të avancuar për monitorimin e politikave publike, e cila mundëson një vlerësim të bazuar në tregues dhe rezultate konkrete. Megjithatë, funksionimi efektiv i kësaj strukture varet nga ekzistenca e kapaciteteve institucionale për raportim të standardizuar dhe për mbledhje të dhënash të verifikueshme. Në mungesë të këtyre elementeve, ekziston rreziku që zbatimi të reduktohet në raportim aktivitetesh, pa të dhëna të qarta mbi përmbushjen e treguesve dhe arritjen e rezultateve të synuara.

Në vijim paraqitet matrica (e thjeshtuar) analitike e përdorur për këtë monitorim, e cila pasqyron në mënyrë të strukturuar elementet kyçe të Aneksit 4 dhe shërben si bazë për vlerësimin dhe analizimin e gjetjeve të çdo institucioni dhe sektori.

QËLLIMI I POLITIKËS I: Përmirësimi i aksesit të personave LGBTI+ në shërbime publike dhe shërbime mbështetëse të specializuara efektive, cilësore dhe të disponueshme në mbarë vendin, në përputhje me nevojat specifike të tyre dhe me standardet kombëtare të harmonizuara me ato evropiane dhe ndërkombëtare.

Objektivi specifik I.1: Ofrimi i shërbimeve të përkujdesjes shoqërore cilësore dhe miqësore ndaj personave LGBTI+.

Treguesit kryesorë:		1. Numri i shërbimeve mbështetëse të specializuara me standarde të përmirësuara dhe të përshtatura për trajtimin e personave LGBTI+; 2. Përqindja e buxhetit të shtetit e alokuar për funksionimin e shërbimeve mbështetëse të specializuara për personat LGBTI+.			
Nr.	Masa / Aktiviteti	Produkti	Institucioni Përgjegjës	Institucione Partnere	Afati
I.1.1.a	Moduli trajnues për nëpunës civilë mbi të drejtat LGBTI+	Moduli i përgatitur	Shkolla Shqiptare e Administratës Publike	Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Avokati i Popullit,	6M-II 2021 - 6M-I

				Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, Organizata Jofitimprurëse	2022
I.1.1.b	Trajnim i përvitshëm i nëpunësve civilë qendrorë e vendorë	Nëpunës civilë të trajnuar	Shkolla Shqiptare e Administratës Publike	Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, ministritë e linjës, Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore	6M-II 2022 - 6M-II 2027
I.1.1.c	Trajnim Njësia për Barazi Gjinore qendrore	Njësia për Barazi Gjinore qendrore e trajnuar	Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale	Ministritë e linjës	6M-II 2021
I.1.1.d	Trajnim Njësia për Barazi Gjinore vendorë dhe Komiteti i Koordinimit kundër Dhunës në Familje në 61 bashki	Njësia për Barazi Gjinore dhe Komitetet vendorë të trajnuar	Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale	Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore	6M-II 2021 - 6M-I 2022
I.1.2.a	Rishikim standardesh për 3 lloj shërbimesh mbështetëse	3 standarde të rishikuara	Shërbimi Social Shtetëror	Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore, Avokati i Popullit, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,	6M-I 2022 - 6M-II 2022

				Organizata Jofitimprurëse	
I.1.2.b	Trajnim punonjës shërbimesh mbështetëse	Punonjës të trajnuar	Shërbimi Social Shtetëror	Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore, Avokati i Popullit, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, Organizata Jofitimprurëse	6M-I 202 3 - 6M- II 202 4
I.1.2.c	Trajnim ekipet e Mekanizmit të Koordinuar të Referimit dhe të Njesisë së Mbrojtjes së Fëmijës në nivel bashkie (61 Mekanizma të Koordinuar të Referimit)	61 Mekanizma të Koordinuar të Referimit të gatshëm	Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore	Ministria e Brendshme/Agjencia e Mbrojtjes nga Vendndodhja e Viktimave, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi	6M-I 202 2 - 6M- II 202 7
I.1.2.d	Mbledhje të dhënash dhe monitorim ankesash Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi	Raporti i monitorimit	Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi	Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore, Instituti Shqiptar i Statistikave, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes	6M-I 202 2 - 6M-I 202 7

				Sociale, Organizata Jofitimprurëse	
I.1.3.a	Mbështetje financiare 'Streha'	Qendra Streha funktionale sipas standardeve	Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale	Ministria e Financave, Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore, Organizata Jofitimprurëse	6M- II 202 1 - 6M- II 202 7
I.1.3.b	Shtrirje strehimi në dy qarqe të tjera	Shërbim i zgjeruar	Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale	Ministria e Financave, Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore, Organizata Jofitimprurëse	6M-I 202 3 - 6M- II 202 7
I.1.3.c	Akses bonus qiraje dhe banesa sociale	Nr. LGBTI+ përfitues strehimi	Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore	Ministria e Brendshme/Agje ncia e Mbrojtjes nga Vendndodhja e Viktimave, Ministria e Financave, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale	6M-I 202 2 - 6M- II 202 7
I.1.4.a	Fuqizim shërbimit SOS LGBTI+	SOS LGBTI+ mbështetur	Ministria e Shëndetësisë	Ministria e Brendshme/Agje ncia e Mbrojtjes	6M-I 202 3 -

		financiarisht nga shteti	dhe Mbrojtjes Sociale	nga Vendndodhja e Viktimave, Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore, Ministria e Financave dhe Ekonomisë	6M-II 2027
I.1.4.b	Pilotim këshillimi prindëror (5 qendra Tiranë)	5 programe këshillimi familjar	Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore	Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Ministria e Brendshme/Agjencia e Mbrojtjes nga Vendndodhja e Viktimave, Fakulteti i Shkencave Sociale	6M-I 2023 - 6M-II 2025
I.1.4.c	Shtrirje këshillimi prindëror në dy qarqe të tjera	Modeli i replikuar	Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore	Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Ministria e Brendshme/Agjencia e Mbrojtjes nga Vendndodhja e Viktimave, Fakulteti i	6M-I 2026 - 6M-II 2027

				Shkencave Sociale	
Objektivi specifik I.2: Zvogëlimi i pabarazive dhe diskriminimit të personave LGBTI+ në arsim.					
Treguesit kryesorë:		1. Numri i nxënësve/studentëve LGBTI+ që raportojnë diskriminim dhe trajtohen sipas standardeve.			
Nr.	Masa / Aktiviteti	Produkti	Institucioni Përgjegjës	Institucione Partnere	Afati
I.2.1.a	Modul trajnimi arsim parauniversitar (çështje LGBTI+)	Moduli i akredituar	Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin Parauniversitar	Ministria e Arsimit dhe Sportit, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, Organizata Jofitimprurëse	6M-I 202 2 - 6M-II 202 2
I.2.1.b	Trajnim profesionistësh arsimit parauniversitar	Profesionistë të trajnuar	Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin Parauniversitar	Ministria e Arsimit dhe Sportit, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, Organizata Jofitimprurëse	6M-I 202 3 - 6M-II 202 7
I.2.2.a	Modul LGBTI+ në kurrikulën e	Kurrikula e përmirësuar	Universiteti i Tiranës -	Ministria e Arsimit dhe	6M-II

	shkencave sociale (Universiteti i Tiranës - Fakulteti i Shkencave Sociale)		Fakulteti i Shkencave Sociale	Sportit, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Organizata Jofitimprurëse	2022 - 6M-II 2027
I.2.2.b	Modul LGBTI+ në kurrikulën e shkencave të edukimit (Universiteti i Tiranës - Fakulteti i Historisë dhe Filologjisë)	Kurrikula e përmirësuar	Universiteti i Tiranës - Fakulteti i Historisë dhe Filologjisë	Ministria e Arsimit dhe Sportit, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Organizata Jofitimprurëse	6M-II 2022 - 6M-II 2027
I.2.2.c	Modul LGBTI+ në kurrikulën e drejtësisë (Universiteti i Tiranës - Fakulteti i Drejtësisë)	Kurrikula e përmirësuar	Universiteti i Tiranës - Fakulteti i Drejtësisë	Ministria e Arsimit dhe Sportit, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Organizata Jofitimprurëse	6M-II 2022 - 6M-II 2027
I.2.2.d	Modul LGBTI+ trajnim fillestar dhe vazhdues gjyqtarë e prokurorë	Kurrikula e përmirësuar	Shkolla e Magjistraturës	Ministria e Drejtësisë, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Organizata Jofitimprurëse	6M-II 2022 - 6M-II 2027
I.2.2.e	Modul LGBTI+ kurrikula policimit	Kurrikula e përmirësuar	Akademia e Sigurisë	Ministria e Brendshme/Policia e Shtetit	6M-II 2022

	(Akademia e Sigurisë)			Shqiptar, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale	2 - 6M-II 2027
I.2.2.f	Modul LGBTI+ kurrikula mjekësisë (Universiteti i Mjekësisë, Tiranë)	Kurrikula e përmirësuar	Universiteti i Mjekësisë, Tiranë	Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Organizata Jofitimprurëse	6M-II 2027

Objektivi specifik I.3: Përmirësimi i aksesit në shërbime shëndetësore cilësore për personat LGBTI+.

Treguesit kryesorë:

1. Numri i profesionistëve të trajnuar;
2. Ekzistenca e protokolleve mjekësore të miratuara;
3. Numri i testeve HIV/SST të ofruara.

Nr.	Masa / Aktiviteti	Produkti	Institucioni Përgjegjës	Institucione Partnere	Afati
I.3.1.a	Rishikim moduli trajnues kujdesi shëndetësor parësor	Moduli i akredituar	Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale	Operatori i Shërbimit të Kujdesit Shëndetësor/Njësia Vendore e Kujdesit Shëndetësor, Organizata Jofitimprurëse	6M-II 2027
I.3.1.b	Trajnim 360 profesionistësh	360 profesionistë/vit	Operatori i Shërbimit të Kujdesit	Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes	6M-II 2027

	shëndetësor parësor/vit		Shëndetësor/Njësia Vendore e Kujdesit Shëndetësor	Sociale, Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore, Organizata Jofitimprurëse	2 - 6M-I 202 7
I.3.2.a	Hartim Protokolli mjekësor transgjjinor	Protokolli i miratuar	Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale	Operatori i Shërbimit të Kujdesit Shëndetësor, Njësia Vendore e Kujdesit Shëndetësor, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi	6M-I 202 2 - 6M-II 202 2
I.3.2.b	Trajnim ~1 500 mjekë specialistë dhe mjekë familjeje	~1 500 profesionistë të trajnuar	Operatori i Shërbimit të Kujdesit Shëndetësor/Njësia Vendore e Kujdesit Shëndetësor	Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore, Organizata Jofitimprurëse	6M-I 202 3 - 6M-II 202 7
I.3.2.c	Përditësim dokumentacion shëndetësor sipas ICD-X	Dokumentacioni i unifikuar	Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale	Njësia Vendore e Kujdesit Shëndetësor, Qendra Spitalore Universitare 'Nënë Tereza', Organizata Jofitimprurëse	6M-II 202 2 - 6M-I 202 3
I.3.2.d	Grumbullim sistematik të	Të dhëna të përditësuara	Ministria e Shëndetësisë	Njësia Vendore e Kujdesit	6M-II

	dhënash LGBTI+ shëndetësore		dhe Mbrojtjes Sociale	Shëndetësor, Qendra Spitalore Universitare 'Nënë Tereza', Organizata Jofitimprurëse	202 3 - 6M-I 202 7
I.3.2.e	Testim anonim SST/HIV anekënd vendit	Nr. testesh SST/HIV	Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale	Njësia Vendore e Kujdesit Shëndetësor, Organizata Jofitimprurëse	6M-II 202 1 - 6M-II 202 7

Objektivi specifik I.4: Zvogëlimi i barrierave në punësim dhe promovimi i punës së denjë për personat LGBTI+.

Nr.	Masa / Aktiviteti	Produkti	Institucioni Përgjegjës	Institucione Partnere	Afati
I.4.1.a	Fletëpalosje informuese mbi shërbime punësimi (2 000 copë)	Fletëpalosjet e shpërndara	Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive	Agjencia Kombëtare e Arsimit dhe Formimit Profesional, Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Organizata Jofitimprurëse	6M-II 202 2
I.4.1.b	Bashkëpunim Organizata Jofitimprurëse LGBTI+ për	LGBTI+ të evidentuar te Zyra Vendore e Punësimit	Shërbimi Kombëtar i Punësimit/Zyra Vendore e Punësimit	Agjencia Kombëtare e Arsimit dhe Formimit Profesional,	6M-I 202 2 - 6M-II

	regjistrim punëkërkues			Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive, Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Organizata Jofitimprurëse	2027
I.4.1.c	Trajnim 180 punonjës shërbimesh punësimit/vit	180 punonjës/vit	Shërbimi Kombëtar i Punësimit/Zyra Vendore e Punësimit	Agjencia Kombëtare e Arsimit dhe Formimit Profesional, Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive, Ministria e Financave dhe Ekonomisë	6M-I 2022 - 6M-II 2027
I.4.1.d	Subvencionim 30 sipërmarrjesh LGBTI+ (fokus digjital/ekologjik)	30 subvencionim e	Ministria e Financave dhe Ekonomisë	Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Ministria e Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes, institucionet financiare qendrore	6M-I 2023 - 6M-II 2027

QËLLIMI I POLITIKËS II: Garantimi i mbrojtjes efektive dhe sigurisë për personat LGBTI+ nëpërmjet përmirësimit dhe zbatimit të kuadrit ligjor, forcimit të mekanizmave institucionalë dhe rritjes së aksesit në sistemin e drejtësisë.

Objektivi specifik II.1: Përmirësimi i kuadrit ligjor për mbrojtjen e të drejtave të personave LGBTI+, në përputhje me standardet kombëtare dhe ndërkombëtare të të drejtave të njeriut.

Nr.	Masa / Aktiviteti	Produkti	Institucioni Përgjegjës	Institucione Partnere	Afati
II.1.1.a	Analizë Kodi Penal; raport me rekomandime	Raporti i analizës	Ministria e Drejtësisë	Avokati i Popullit, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Ministria e Brendshme, Organizata Jofitimprurëse	6M-I 202 2 - 6M- II 202 3
II.1.1.b	Projektproponim ndryshime Kodi Penal; dorëzim Kuvend	Projektproponimi i dorëzuar	Ministria e Drejtësisë	Avokati i Popullit, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Ministria e Brendshme, Organizata Jofitimprurëse	6M-I 202 4 - 6M- II 202 4

II.1.1.c	Miratim ndryshimeve Kodi Penal nga Kuvendi	Kodi Penal i ndryshuar	Kuvendi	Ministria e Drejtësisë, Avokati i Popullit, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale	6M-I 202 4 - 6M-II 202 4
II.1.2.a	Analizë Kodi i Familjes (martesë/bashkëjetesë; e drejta ndërkombëtare private)	Raporti i analizës	Ministria e Drejtësisë	Avokati i Popullit, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Ministria e Brendshme, Organizata Jofitimprurëse	6M-I 202 4 - 6M-II 202 6
II.1.2.b	Projektproponim ndryshime Kodi i Familjes; dorëzim Kuvend	Projektproponimi i dorëzuar	Ministria e Drejtësisë	Avokati i Popullit, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Organizata Jofitimprurëse	6M-I 202 7 - 6M-II 202 7
II.1.3.a	Projektligj njohje identitetit gjinor	Projektligji i përgatitur	Ministria e Shëndetësisë	Ministria e Drejtësisë,	6M-I 202

	dhe mbrojtje interseks		dhe Mbrojtjes Sociale	Avokati i Popullit, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, Ministria e Brendshme, Organizata Jofitimprurëse	4 - 6M-II 2025
II.1.3. b	Miratim projektligjit nga Kuvendi	Ligji i miratuar	Kuvendi	Ministria e Drejtësisë, Avokati i Popullit, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale	6M-I 2026 - 6M-II 2026
II.1.3. c	Përmirësim ligji shëndet riprodhues (të drejta LGBTI+)	Projektligji i përgatitur	Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale	Ministria e Drejtësisë, Avokati i Popullit, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, Ministria e Brendshme, Organizata Jofitimprurëse	6M-I 2022 - 6M-II 2023
II.1.4. a	Propozime ligj nxitjes punësimit; aktet nënligjore	Projektligji i përgatitur	Ministria e Financave dhe Ekonomisë	Ministria e Drejtësisë, Avokati i Popullit, Komisioneri për Mbrojtjen nga	6M-I 2022 - 6M-II

				Diskriminimi, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale	202 2
II.1.5.a	Propozime ndryshime ligji azil dhe gjendjes civile	Projektligjet e përgatitura	Ministria e Brendshme	Ministria e Drejtësisë, Avokati i Popullit, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale	6M-I 202 3 - 6M- II 202 4

Objektivi specifik II.2: Forcimi i mekanizmave institucionalë për parandalimin, identifikimin dhe adresimin e diskriminimit dhe dhunës ndaj personave LGBTI+, si dhe përmirësimi i aksesit të tyre në drejtësi.

Nr.	Masa / Aktiviteti	Produkti	Institucioni Përgjegjës	Institucione Partnere	Afati
II.2.1.a	Mbledhje të dhënash dhe raport vjetor diskriminim/krime urrejtjeje LGBTI+	Raporti vjetor i Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi	Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi	Avokati i Popullit, Ministria e Drejtësisë, Ministria e Brendshme/Policia e Shtetit Shqiptar, Prokuroria e Përgjithshme, Organizata Jofitimprurëse	6M-I 202 2 - 6M- II 202 7

II.2.1. b	Miratim raporti Grupi Kombëtar për Zbatim dhe Koordinim; dorëzim Këshillit të Evropës	Raporti i miratuar dhe dorëzuar	Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi	Avokati i Popullit, Ministria e Drejtësisë, Ministria e Brendshme/Policia e Shtetit Shqiptar, Organizata Jofitimprurëse	6M-I 202 2 - 6M-II 202 7
II.2.2. a	Caktim 61 pikave fokale LGBTI+ në Policia e Shtetit Shqiptar (Drejtori Vendore Policie/Komisariate)	61 persona me detyrë pika fokale	Policia e Shtetit Shqiptar / Ministria e Brendshme	—	6M-I 202 2 - 6M-II 202 7
II.2.2. b	Trajnim 61 pikave fokale: regjistrim/trajtim raportimesh	61 pika fokale të trajnuara	Policia e Shtetit Shqiptar	Ministria e Brendshme, Akademia e Sigurisë	6M-I 202 2 - 6M-II 202 7
II.2.3. a	Modul trajnimi ndihma juridike falas	Moduli i përgatitur	Ministria e Drejtësisë / Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas	Dhoma Kombëtare e Avokatisë, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, Avokati i Popullit	6M-I 202 2 - 6M-II 202 2
II.2.3. b	Trajnim 30 profesionistësh ndihma juridike/vit	30 profesionistë/vit	Ministria e Drejtësisë / Drejtoria e	Dhoma Kombëtare e Avokatisë,	6M-I 202 3 -

			Ndihmës Juridike Falas	Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, Avokati i Popullit	6M-II 2027
II.2.4. a	Raport vjetor monitorimit zbatimit Planit Kombëtar të Veprimit LGBTI+ 2021-2027	Raporti vjetor i monitorimit	Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale	Të gjitha institucionet	6M-I 2027 2 - 6M-II 2027
II.2.4. b	Raport vlerësimi ndërmjetëm Plani Kombëtar i Veprimit	Raporti i vlerësimit ndërmjetëm	Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale	Të gjitha institucionet	6M-I 2025
II.2.4. c	Raport vlerësimi final Plani Kombëtar i Veprimit	Raporti i vlerësimit final	Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale	Të gjitha institucionet	6M-I 2027

QËLLIMI I POLITIKËS III: Krijimi dhe promovimi i një shoqërie gjithëpërfshirëse, të barabartë dhe jodiskriminuese, përmes rritjes së ndërgjegjësimit publik, luftimit të stereotipeve dhe paragjykimeve, si dhe fuqizimit të pjesëmarrjes së personave LGBTI+ në jetën sociale, ekonomike dhe publike.

Objektivi specifik III.1: Rritja e ndërgjegjësimit të publikut dhe institucioneve mbi të drejtat e personave LGBTI+ dhe promovimi i një kulture respekti dhe përfshirjeje.

Nr.	Masa / Aktiviteti	Produkti	Institucioni Përgjegjës	Institucione Partnere	Afati
III.1.1. a	6 fushata kombëtare Dita Ndërkombëtare kundër	6 fushata kombëtare	Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale	Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, Avokati i Popullit,	6M-I 2027 2 - 6M-I

	Homofobisë, Transfobisë dhe Bifobisë (1/vit)			Ministritë e linjës, Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore, Organizata Jofitimprurëse, mediat	202 7
III.1.1. b	Trajnim 30 gazetarësh/vit	30 gazetarë/vit	Autoriteti i Mediave Audiovizive	Fakulteti i Gazetarisë, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, Avokati i Popullit, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Organizata Jofitimprurëse	6M-I 202 2 - 6M-I 202 7
III.1.1. c	Monitorim vjetor medias mbi gjuhën e urrejtjes LGBTI+	1 raport monitorimi/vit	Autoriteti i Mediave Audiovizive	Fakulteti i Gazetarisë, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, Avokati i Popullit, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Organizata Jofitimprurëse	6M-I 202 2 - 6M-I 202 7

III.1.1.d	Studim perceptimi publik ndaj LGBTI+ (çdo 4 vjet)	Studimi i përgatitur	Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale	Instituti Shqiptar i Statistikave, Ministria e Drejtësisë, Avokati i Popullit, Institucionet e Arsimit të Lartë, Organizata Jofitimprurëse	2022-2023 dhe 2026-2027
III.1.1.e	Aktivitet kulturor vjetor me tematikë LGBTI+	Aktiviteti i zhvilluar çdo vit	Ministria e Kulturës	Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, Avokati i Popullit, Ministrinë e linjës, Organizata Jofitimprurëse	6M-I 2022 - 6M-I 2027

Objektivi specifik III.2: Përmirësimi i ndërgjegjësimit dhe promovimi i praktikave jodiskriminuese në tregun e punës dhe në institucionet publike dhe private.

Nr.	Masa / Aktiviteti	Produkti	Institucioni Përgjegjës	Institucione Partnere	Afati
III.2.1.a	Karta Kombëtare e Diversitetit (gati për nënshkrim)	Karta e përgatitur	Ministria e Financave dhe Ekonomisë	Dhoma e Tregtisë, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, Avokati i Popullit, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Organizata Jofitimprurëse	6M-I 2022 - 6M-II 2022

III.2.1. b	15 takime informuese me bizneset	15 takime të realizuara	Ministria e Financave dhe Ekonomisë	Dhoma e Tregtisë, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, Avokati i Popullit, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale	6M-I 202 2 - 6M- II 202 2
III.2.1. c	50 biznese nënshkruajnë Kartën deri 2027	Karta e nënshkruar nga 50 biznese	Ministria e Financave dhe Ekonomisë	Dhoma e Tregtisë, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, Avokati i Popullit	6M-I 202 3 - 6M- II 202 7
III.2.1. d	Politikë kundër diskriminimit LGBTI+ institucionet shtetërore qendrore	Politika e miratuar	Ministritë e linjës	Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, Avokati i Popullit, Organizata Jofitimprurëse	6M-I 202 2 - 6M- II 202 7
III.2.1. e	Politikë kundër diskriminimit LGBTI+ institucionet shtetërore vendore	Politika e miratuar	Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore	Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, Avokati i Popullit, Organizata Jofitimprurëse	6M-I 202 2 - 6M- II 202 7

4. GJETJET KRYESORE TË MONITORIMI

Ky kapitull paraqet analizën kryesore të nivelit të zbatimit të Planit Kombëtar të Veprimit për Personat LGBTI+ 2021-2027, të ndërtuar mbi logjikën e ndërhyrjes së përcaktuar në Aneksin 4 të Planit. Analiza bazohet në një shqyrtim të strukturuar të përgjigjeve zyrtare të institucioneve, dokumentacionit të disponueshëm dhe të dhënave të mbledhura përmes metodologjisë së monitorimit të përshkruar më sipër.

Në këtë kuadër, vlerësimi fokusohet në përputhjen ndërmjet aktiviteteve të raportuara, produkteve të parashikuara dhe treguesve të matshëm, duke synuar të evidentojë jo vetëm nivelin formal të zbatimit të PKV-së, por edhe shkallën reale dhe të dokumentueshme të përmbushjes së objektivave të Planit.

4.1 Panorama e përgjithshme e zbatimit

Analiza e kombinuar e përgjigjeve institucionale ndaj kërkesave për informacion, dokumentacionit të disponueshëm dhe perspektivës së komunitetit LGBTI+, evidenton se zbatimi i Planit Kombëtar të Veprimit për Personat LGBTI+ 2021-2027, gjatë periudhës 2021-2025, mbetet i pjesshëm, i fragmentuar dhe i pabarabartë ndërmjet sektorëve dhe niveleve të qeverisjes. Progresi i dokumentueshëm rezulton në një numër të kufizuar përgjigjesh institucionale, ku përmendim veçanërisht rastin e Shkollës së Magjistraturës, Avokatit të Popullit dhe Ministrisë së Turizmit, Kulturës dhe Sportit. Megjithatë, zbatimi mbetet i kufizuar në shtrirje, i paqëndrueshëm në kohë dhe në pjesën më të madhe i varur nga iniciativa të mbështetura nga aktorë të jashtëm, si shoqëria civile dhe organizatat ndërkombëtare.

Gjetja kryesore horizontale e këtij monitorimi është se problematika më e theksuar nuk qëndron vetëm në mungesën e zbatimit të aktiviteteve të planifikuara nga institucionet përgjegjëse, por në mungesën e kapacitetit institucional për të dokumentuar, gjurmuar dhe raportuar zbatimin e PKV-së në përputhje me logjikën dhe treguesit e përcaktuar nga vetë Aneksi 4 i Planit. Ky boshllëk strukturor, i identifikuar gjithashtu edhe në vlerësimin e planit pararendës 2016-2020, rezulton të mbetet i paadresuar në mënyrë efektive në fazën aktuale të zbatimit.

Si pasojë, një pjesë e konsiderueshme e aktiviteteve të raportuara nga institucionet mbeten të pamjaftueshme për t'u konsideruar si zbatim real në kuptimin e Aneksit 4, pasi nuk shoqërohen me produkte të formalizuara, tregues të matshëm apo evidencë të verifikueshme të rezultateve. Në mungesë të këtyre elementeve, vlerësimi i progresit

institucional mbetet i kufizuar. Kjo situatë tregon se sfida kryesore e zbatimit të PKV-së nuk lidhet vetëm me realizimin efektiv të aktiviteteve të planifikuara, por me mungesën e një sistemi funksional dhe të standardizuar të monitorimit dhe raportimit mbi zbatimin, i cili do të mundësonte gjurmueshmëri, krahasueshmëri dhe llogaridhënie reale të progresit institucional në kohë.

4.2 Pasqyra e vlerësimit të përgjithshëm të rezultateve të monitorimit sipas objektivave

Objektivi specifik	Institucionet kryesore	Vlerësimi i zbatimit	Trendi	Raportimi / Përgjigje
Qëllimi i Politikës I: Përmirësimi i aksesit të personave LGBTI+ në shërbime publike dhe shërbime mbështetëse efektive, cilësore dhe të disponueshme në mbarë vendin.				
I.1 <i>Shërbime sociale dhe mbështetëse për personat LGBTI+ (strehim, këshillim, SOS, mekanizma referimi)</i>	Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale Shërbimi Social Shtetëror Bashkitë (Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore)	Minimalisht i zbatuar	↑	Po (të pjesshme)
I.2 <i>Kapacitete profesionale në arsim, trajnim dhe kurrikula mbi të drejtat LGBTI+ (parauniversitar, universitar, drejtësi, polici, mjekësi)</i>	Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin Parauniversitar Institucionet e Arsimit të Lartë Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas	Pjesërisht i zbatuar	↑	Po (të pjesshme)
I.3 <i>Shërbime shëndetësore cilësore dhe miqësore për</i>	Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale	Minimalisht i zbatuar	↔	Po

Objektivi specifik	Institucionet kryesore	Vlerësimi i zbatimit	Trendi	Raportimi / Përgjigje
<i>personat LGBTI+ (trajnim profesionistësh, protokolle, testim HIV/SST)</i>	Universiteti i Mjekësisë Tiranë			
I.4 <i>Punësimi dhe tregu i punës, zvogëlimi i barrierave dhe promovimi i punës së denjë për personat LGBTI+</i>	Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive Ministria e Financave dhe Ekonomisë Shërbimi Kombëtar i Punësimit	I pazbatuar (pa të dhëna të raportuara)	↔	Jo (Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive, Shërbimi Kombëtar i Punësimit)
Qëllimi i Politikës II: Garantimi i mbrojtjes efektive dhe sigurisë për personat LGBTI+ nëpërmjet përmirësimit të kuadrit ligjor dhe rritjes së aksesit në drejtësi.				
II.1 <i>Mbrojtja ligjore dhe aksesit në drejtësi, reforma legjislativë (Kodi Penal, Kodi i Familjes, identiteti gjinor, legjislativë i punës, azili)</i>	Ministria e Drejtësisë Shkolla e Magjistraturës Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas	Minimalisht i zbatuar	↑	Të pjesshme
II.2 <i>Zbatimi i legjislativë kundër diskriminimit dhe krimeve të urrejtjes, mekanizma institucionale dhe raportim</i>	Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi Policia e Shtetit Shqiptar	I pazbatuar (pa të dhëna të raportuara)	↔	Jo (Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, Ministria e Brendshme)

Objektivi specifik	Institucionet kryesore	Vlerësimi i zbatimit	Trendi	Raportimi / Përgjigje
Qëllimi i Politikës III: Krijimi i një shoqërie gjithëpërfshirëse dhe jo diskriminuese nëpërmjet ndërgjegjësimit publik dhe fuqizimit të personave LGBTI+.				
III.1 <i>Media, kulturë dhe ndërgjegjësim publik, fushata, trajnim gazetarësh, monitorim mediash, studim perceptimi publik, aktivitete kulturore</i>	Autoriteti i Mediave Audiovizive Ministria e Kulturës	Pjesërisht i zbatuar	↑	Po
III.2 <i>Ndërgjegjësimi i punëdhënësve: Karta Kombëtare e Diversitetit, politika kundër diskriminimit në institucionet publike dhe private</i>	Ministria e Financave dhe Ekonomisë	I pazbatuar	↔	Po (jo substantive)
Koordinimi, monitorimi dhe menaxhimi i të dhënave				
<i>Koordinimi institucional, monitorimi vjetor i zbatimit të Planit Kombëtar të Veprimit LGBTI+ 2021-2027 dhe menaxhimi i të dhënave të disagreguara</i>	Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe të gjitha institucionet e angazhuara	I pazbatuar	↓	Shumica e kërkesave për informacion mbeten pa përgjigje; Shumica e përgjigjeve të marra mbeten sipërfaqësore

Objektivi specifik	Institucionet kryesore	Vlerësimi i zbatimit	Trendi	Raportimi / Përgjigje
				dhe nuk i përgjigjen strukturës së raportimit të zbatimit sipas Aneksit 4.
<p>Legjenda: I pazbatuar Minimalisht i zbatuar Pjesërisht i zbatuar Trendi: ↑ përmirësim ↔ pandryshueshmëri ↓ përkeqësim</p>				

5. ANALIZA E ZBATIMIT TË LOGJIKËS NDËRHYRËSE TË PKV-SË: INSTITUCIONET QENDRORE

5.1 Ministria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale (MSHMS)

Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, në cilësinë e institucionit koordinues të Planit Kombëtar të Veprimit për Personat LGBTI+ 2021-2027, në përgjigjen zyrtare të datës **14.10.2025**, në kuadër të Ligjit nr. 119/2014 “Për të Drejtën e Informimit”, raporton një sërë aktiviteteve dhe ndërhyrjesh të ndërmarra në mbështetje të zbatimit të Planit.

Institucioni thekson se ka kontribuar në përmirësimin e kuadrit ligjor dhe politik për mbrojtjen e të drejtave të personave LGBTI+, përfshirë ndërhyrje në legjislacion dhe politika të lidhura me luftën kundër diskriminimit dhe gjuhës së urrejtjes, si dhe ndryshime në ligjin për mediat audiovizive në vitin 2023.

Në aspektin e shërbimeve, Ministria raporton mbështetje financiare të vazhdueshme për Qendrën Streha që prej vitit 2019, si dhe akses të personave LGBTI+ në shërbime në qendrën LILIUM dhe në qendrat “One Stop” në Shkodër dhe Fier.

Në lidhje me ndërtimin e kapaciteteve të nëpunësve civilë, raportohen trajnime të zhvilluara përmes Shkollës Shqiptare të Administratës Publike gjatë vitit 2024, me pjesëmarrjen e 352 profesionistëve, si dhe hartimi i një kurrikule e-learning mbi të drejtat e komunitetit LGBTI+.

Në fushën e shëndetësisë, Ministria raporton zhvillimin e takimeve të grupit të punës për hartimin e protokollit për trajtimin hormonal të personave transgjjinorë, si dhe organizimin e aktiviteteve konsultative dhe trajnuese mbi këtë temë.

Gjithashtu, evidentohet organizimi i aktiviteteve ndërgjegjësuere dhe ndërinstitucionale, përfshirë dialogje në kuadër të Ditës Ndërkombëtare kundër Homofobisë, si dhe pjesëmarrja institucionale në Paradën e Krenarisë në maj 2025.

Ministria thekson gjithashtu bashkëpunimin me organizatat e shoqërisë civile dhe partnerët ndërkombëtarë, si dhe faktin se ka nisur procesin e monitorimit të zbatimit të Planit duke dërguar kërkesa për informacion institucioneve të tjera përgjegjëse.

5.1.1 Vlerësimi në raport me Aneksin 4

Në raport me detyrimet e përcaktuara në Aneksin 4, një pjesë e aktiviteteve të raportuara lidhen me masat për ndërtimin e kapaciteteve dhe ndërgjegjësimin, veçanërisht në kuadër të objektivave I.1 dhe I.3. Megjithatë, nuk evidentohet përmbushja e produkteve kyçe të këtyre objektivave të parashikuara nga Plani.

Në mënyrë specifike, standardet e rishikuara për shërbimet sociale (masa I.1.2.a) nuk rezultojnë të finalizuara, ndërkohë që shtrirja territoriale e shërbimit rezidencial (masa I.1.3.b) nuk provohet të jetë realizuar. Në fushën e shëndetësisë, protokollin për personat transgjjinorë mbetet në fazë diskutimi dhe nuk rezulton i miratuar, duke mos përmbushur produktin e parashikuar nga masat përkatëse.

Gjithashtu, nuk evidentohet përmbushja e plotë e treguesve për trajnimin sistematik dhe të vazhdueshëm të profesionistëve të kujdesit shëndetësor, as në aspektin e targeteve vjetore dhe as në atë të mbulimit territorial.

Në lidhje me mekanizmat institucionalë, nuk evidentohet funksionalizimi i plotë i strukturave të parashikuara për koordinim dhe zbatim, përfshirë elemente si pikat fokale, të cilat janë thelbësore për implementimin ndërsektorial të Planit.

5.1.2 Vlerësimi i cilësisë së raportimit

Përgjigjja institucionale është kryesisht përshkruese dhe nuk ndjek strukturën e treguesve të Aneksit 4. Nuk paraqiten të dhëna të strukturuar që të lejojnë matjen e progresit në raport me indikatorët e përcaktuar, si dhe mungojnë të dhëna të qarta mbi produktet e realizuara dhe buxhetin.

Në mënyrë të veçantë:

- ! Nuk raportohen të dhëna mbi përmbushjen e treguesve të matshëm;
- ! Mungon informacion mbi burimet financiare të përdorura për zbatimin e masave;
- ! Nuk bëhet dallim i qartë ndërmjet aktiviteteve të ndërmarra nga vetë institucioni dhe atyre të realizuara në bashkëpunim me organizatat e shoqërisë civile dhe partnerët ndërkombëtarë;
- ! Aktivitetet e raportuara nuk shoqërohen me evidencë të verifikueshme mbi rezultatet e arritura.

Për rrjedhojë, një pjesë e konsiderueshme e aktiviteteve të raportuara nuk mund të konsiderohen si progres i dokumentueshëm në kuptimin e Aneksit 4, pasi nuk lidhen në mënyrë të drejtpërdrejtë me produktet dhe treguesit e parashikuar.

Vlerësimi:

Minimalisht i zbatuar ↑

5.2 Shërbimi Social Shtetëror (SHSSH)

Shërbimi Social Shtetëror, në përgjigjen zyrtare të datës **28.10.2025**, në kuadër të Ligjit nr. 119/2014 “Për të Drejtën e Informimit”, raporton mbi masat e ndërmarra në lidhje me zbatimin e Planit Kombëtar të Veprimit për Personat LGBTI+, veçanërisht në kuadër të objektivave që lidhen me përmirësimin e shërbimeve sociale.

Në lidhje me masën I.1.2.a, institucioni informon se është miratuar vetëm korniza e standardeve bazë të cilësisë së shërbimeve të kujdesit shoqëror, ndërsa thekson se standardet specifike për kategori të ndryshme përfituesish, përfshirë personat LGBTI+, janë ende në proces rishikimi dhe nuk janë miratuar.

Në lidhje me masën I.1.2.b, Shërbimi Social Shtetëror raporton se punonjës të tij dhe të Drejtorive Rajonale, si dhe punonjës të disa ofruesve të shërbimeve sociale (përfshirë Qendrën “Streha”), kanë marrë pjesë në trajnime të organizuara nga organizata të shoqërisë civile mbi tema që lidhen me shërbimet e diferencuara dhe identifikimin e rasteve emergjente, përfshirë ato që lidhen me personat LGBTI+.

Institucioni gjithashtu thekson, se trajnimet për ofrimin e shërbimeve në përputhje me standardet e reja do të organizohen pasi këto standarde të miratohen.

5.2.1 Vlerësimi në raport me Aneksin 4

Në raport me detyrimet e përcaktuara në Aneksin 4, evidentohet se produkti kryesor i masës I.1.2.a, që lidhet me rishikimin dhe miratimin e standardeve specifike për shërbimet mbështetëse, nuk është përmbushur, pavarësisht se afati i parashikuar për këtë masë ka kaluar. Miratimi i kornizës së përgjithshme të standardeve nuk përmbush kërkesën për hartimin dhe miratimin e standardeve specifike për shërbimet e kujdesit shoqëror, përfshirë shërbimet mbështetëse të specializuara dhe integrimin në to të parimeve dhe standardeve

të ofrimit të shërbimeve miqësore për personat LGBTI+, të cilat janë thelbësore për garantimin e shërbimeve të përshtatura ndaj nevojave të tyre.

Në lidhje me masën I.1.2.b, megjithëse raportohen trajnime të zhvilluara, këto nuk rezultojnë të jenë të organizuara në mënyrë sistematike nga vetë institucioni dhe lidhen kryesisht me iniciativa të ndërmarra nga organizata të shoqërisë civile. Për më tepër, nuk evidentohet një program i strukturuar trajnimi në përputhje me standardet e reja, as një plan i qartë për zhvillimin e kapaciteteve të stafit në mënyrë të qëndrueshme dhe të matshme.

Në tërësi, masat e lidhura me përmirësimin e cilësisë së shërbimeve sociale nuk rezultojnë të jenë operacionalizuar plotësisht, pasi mungojnë produktet kryesore (standardet specifike të miratuara) dhe një sistem i qëndrueshëm për trajnimin e ofruesve të shërbimeve.

5.2.2 Vlerësimi i cilësisë së raportimit

Përgjigjja institucionale është e kufizuar në përshkrimin e disa hapave të ndërmarrë dhe nuk përmban të dhëna të strukturuar në raport me treguesit e Aneksit 4.

Në mënyrë specifike:

- ! Nuk paraqiten të dhëna numerike mbi numrin e profesionistëve të trajnuar;
- ! Nuk evidentohet përmbushja e treguesve të matshëm të lidhur me masat përkatëse;
- ! Mungon informacioni mbi burimet financiare të përdorura për zbatimin e këtyre masave;
- ! Aktivitetet e raportuara lidhen kryesisht me trajnime të organizuara nga aktorë të jashtëm, pa një rol të qartë drejtues të institucionit;
- ! Nuk paraqitet evidencë mbi rezultatet konkrete të arritura në përmirësimin e shërbimeve të kujdesit shoqëror.

Për rrjedhojë, aktivitetet e raportuara nuk mund të konsiderohen si progres i dokumentuar në kuptimin e Aneksit 4, pasi nuk lidhen drejtpërdrejt me produktet dhe treguesit e parashikuar.

Vlerësimi:

Minimalisht i zbatuar ↔

5.3 Shkolla e Magjistraturës

Shkolla e Magjistraturës, në përgjigjen zyrtare të datës 13.10.2025, në kuadër të Ligjit nr. 119/2014 “Për të Drejtën e Informimit”, raporton mbi zbatimin e detyrimeve të saj në kuadër të Planit Kombëtar të Veprimit për Personat LGBTI+ 2021-2027, veçanërisht në lidhje me masat që kanë të bëjnë me trajnimin e profesionistëve të sistemit të drejtësisë.

Institucioni informon, se që prej vitit 2021 temat që lidhen me të drejtat e personave LGBTI+ janë përfshirë në mënyrë të vazhdueshme në Programin e Formimit Vazhdues për gjyqtarët dhe prokurorët. Gjatë periudhës 2021-2025 janë zhvilluar gjithsej 11 trajnime, të cilat kanë trajtuar tema të tilla si: të drejtat e komunitetit LGBTI; ndalimi i diskriminimit dhe trajtimi i krimeve të urrejtjes; efektiviteti i ndjekjes penale në rastet e dhunës me bazë gjinore; si dhe jurisprudenca e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe instrumente të tjera ndërkombëtare.

Gjithashtu, raportohet se këto tema janë të integruara edhe në disa module të Programit të Formimit Fillestar, në lëndë të tilla si e drejta familjare, e drejta kushtetuese dhe e drejta e Bashkimit Evropian, ku trajtohen çështje që lidhen me të drejtat e personave LGBTI+ dhe standardet ndërkombëtare përkatëse.

Një element i rëndësishëm i raportimit është përfshirja e të dhënave buxhetore, ku institucioni informon se buxheti mesatar i përdorur për realizimin e trajnimeve gjatë periudhës 2021-2025 ka qenë **649,307 Lek**, ndërsa për vitin akademik 2025-2026 është planifikuar një buxhet prej **137,624 Lek** për aktivitete të ngjashme trajnuese.

5.3.1 Vlerësimi në raport me Aneksin 4

Në raport me Aneksin 4, aktivitetet e raportuara lidhen drejtpërdrejt me masat për ndërtimin e kapaciteteve të profesionistëve të sistemit të drejtësisë, veçanërisht në kuadër të objektivit për integrimin e tematikave mbi të drejtat e personave LGBTI+ në programet trajnuese.

Evidentohet një përputhje e qartë ndërmjet aktiviteteve të raportuara dhe rezultateve të pritshme, në drejtim të rritjes së kapaciteteve profesionale dhe ndërgjegjësimit të gjyqtarëve dhe prokurorëve mbi çështjet e diskriminimit, krimeve të urrejtjes dhe standardeve ndërkombëtare. Integrimi i këtyre temave në mënyrë të vazhdueshme në programet trajnuese përbën një tregues të rëndësishëm të institucionalizimit të kësaj fushe brenda sistemit të drejtësisë.

Megjithatë, disa elemente të rëndësishme të Aneksit 4 nuk dokumentohen plotësisht. Nuk evidentohet në mënyrë të qartë numri total i përfituesve të trajnimeve dhe mbulimi i tyre në raport me targetet e mundshme, çka kufizon vlerësimin e shkallës së arritjes së treguesve sasiore. Po ashtu, edhe pse temat LGBTI+ rezultojnë të integruara në disa programe ekzistuese, nuk evidentohet ekzistenca e një moduli të formalizuar dhe të standardizuar si produkt i veçantë në kuptimin e Aneksit 4.

5.3.2 Vlerësimi i cilësisë së raportimit

Përgjigjja e Shkollës së Magjistraturës paraqet një nivel relativisht të lartë të cilësisë së raportimit në krahasim me institucionet e tjera të analizuara.

Në mënyrë të veçantë:

- ! Paraqiten të dhëna konkrete mbi numrin e aktiviteteve të realizuara;
- ! Ofrohet informacion i detajuar mbi përmbajtjen e trajnimeve;
- ! Përfshihen të dhëna buxhetore për aktivitetet e realizuara dhe të planifikuara;
- ! Evidentohet integrimi i tematikave mbi të drejtat LGBTI+ në programe trajnuese ekzistuese;
- ! Raportohet mbi burimet financiare të përdorura dhe ato të planifikuara.

Megjithatë, raportimi nuk është plotësisht i strukturuar sipas treguesve të Aneksit 4 dhe nuk përmban të dhëna të plota mbi rezultatet në terma të përfituesve dhe ndikimit të trajnimeve, çka kufizon vlerësimin e plotë të progresit.

Vlerësimi:

Pjesërisht i zbatuar ↑

5.4 Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas (DNJF)

Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas, në përgjigjen zyrtare të datës 09.10.2025, në kuadër të Ligjit nr. 119/2014 “Për të Drejtën e Informimit”, raporton mbi aktivitetet e ndërmarra në lidhje me garantimin e aksesit në drejtësi dhe ofrimin e ndihmës juridike për personat LGBTI+.

Institucioni thekson se, në zbatim të ligjit për ndihmën juridike të garantuar nga shteti, personat LGBTI+ nuk janë përcaktuar si kategori e veçantë përfituese, por mund të

përfitojnë ndihmë juridike falas në rastet kur çështjet e tyre lidhen me shkelje të të drejtave për shkak të diskriminimit.

Në kuadër të zbatimit të Planit, DNJF raporton zhvillimin e një sërë aktiviteteve që lidhen kryesisht me:

- ! Trajnime dhe aktivitete ndërgjegjëse për punonjës të sistemit të ndihmës juridike dhe avokatë të listës shtetërore;
- ! Pjesëmarrje në aktivitete të organizuara nga institucione të tjera, si Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, Avokati i Popullit dhe organizata ndërkombëtare;
- ! Organizim aktiviteteve informuese për qytetarët në bashkëpunim me institucione vendore;
- ! Zhvillim fushatash ndërgjegjëse në nivel kombëtar dhe lokal në kuadër të javëve kundër diskriminimit.

Gjithashtu, në përgjigje paraqitet një listë e detajuar e aktiviteteve të realizuara nga Qendrat e Shërbimit të Ndihmës Juridike Parësore gjatë viteve 2022-2025, të cilat përfshijnë pjesëmarrje në trajnime dhe aktivitete ndërgjegjëse mbi temat e diskriminimit dhe barazisë.

5.4.1 Vlerësimi në raport me Aneksin 4

Në raport me detyrimet e përcaktuara në Aneksin 4, aktivitetet e raportuara lidhen me masat II.2.3.a dhe II.2.3.b, të cilat parashikojnë zhvillimin e një moduli trajnime dhe trajnimit të profesionistëve të ndihmës juridike në mënyrë të strukturuar dhe të vazhdueshme.

Megjithatë, nuk evidentohet përmbushja e produktit kryesor të masës II.2.3.a, që lidhet me përgatitjen dhe formalizimin e një moduli trajnime të dedikuar për çështjet e lidhura me personat LGBTI+. Aktivitetet e raportuara përfshijnë trajnime dhe pjesëmarrje në aktivitete ndërgjegjëse, por nuk provojnë ekzistencën e një moduli të strukturuar dhe të standardizuar në kuptimin e Aneksit 4.

Në lidhje me masën II.2.3.b, nuk evidentohet përmbushja e targetit vjetor për trajnimit të profesionistëve, pasi mungojnë të dhëna mbi numrin e përfituesve dhe mbi shtrirjen e trajnimeve. Aktivitetet e raportuara janë të shpërndara dhe nuk paraqesin një program të qëndrueshëm dhe të matshëm të ndërtimit të kapaciteteve.

Gjithashtu, një pjesë e konsiderueshme e aktiviteteve të raportuara rezulton të jenë të organizuara nga institucione të tjera ose nga partnerë ndërkombëtarë, ndërsa roli i Drejtorisë paraqitet kryesisht si pjesëmarrës, çka kufizon vlerësimin e kontributit të drejtpërdrejtë institucional në zbatimin e Planit.

5.4.2 Vlerësimi i cilësisë së raportimit

Përgjigjja institucionale përmban një listë të detajuar aktiviteteve, por nuk është e strukturuar sipas treguesve dhe produkteve të Aneksit 4.

Në mënyrë specifike:

- ! Nuk paraqiten të dhëna mbi numrin e profesionistëve të trajnuar;
- ! Mungon evidenca mbi përmbushjen e targeteve vjetore të parashikuara;
- ! Nuk jepet informacion mbi burimet financiare të përdorura për zbatimin e masave;
- ! Aktivitetet e raportuara nuk lidhen në mënyrë të drejtpërdrejtë me tregues të matshëm;
- ! Nuk bëhet dallim i qartë ndërmjet rolit të institucionit si organizator dhe si pjesëmarrës në aktivitete.

Për rrjedhojë, aktivitetet e raportuara nuk mund të konsiderohen si progres i dokumentueshëm në kuptimin e Aneksit 4, pasi nuk provojnë përmbushjen e produkteve dhe treguesve të parashikuar.

Vlerësimi:

Minimalisht i zbatuar ↔

5.5 Autoriteti i Mediave Audiovizive (AMA)

Autoriteti i Mediave Audiovizive, në përgjigjen zyrtare të datës 21.10.2025, në kuadër të Ligjit nr. 119/2014 “Për të Drejtën e Informimit”, raporton mbi masat e ndërmarra në lidhje me garantimin e mosdiskriminimit dhe respektimit të të drejtave të personave LGBTI+ në fushën e mediave audiovizive.

Institucioni thekson përmirësime në kuadrin ligjor dhe rregullator, duke iu referuar ligjit për mediat audiovizive dhe harmonizimit të tij me standardet e Bashkimit Evropian, si dhe

përfshirjes së parimeve të mosdiskriminimit dhe mbrojtjes së dinjitetit njerëzor në transmetimet audiovizive.

Një element kyç i raportimit është miratimi i Kodit të rishikuar të Transmetimit (2023), i cili përfshin dispozita specifike që lidhen me mbrojtjen e të drejtave të personave LGBTI+, përfshirë:

- ! Mbrojtjen e privatësisë dhe të të dhënave personale;
- ! Ndalimin e publikimit të imazheve të personave LGBTI+ pa pëlqimin e tyre;
- ! Detyrimin për shmangien e gjuhës homofobe dhe transfobe në raportim;
- ! Kujdesin në pasqyrimin e ngjarjeve që përfshijnë persona LGBTI+, duke shmangur komente paragjyquese dhe identifikimin e tyre pa pëlqim.

Institucioni gjithashtu thekson rolin e tij si autoritet rregullator dhe mbikëqyrës për respektimin e këtyre standardeve nga operatorët e shërbimeve mediatike audiovizive.

5.5.1 Vlerësimi në raport me Aneksin 4

Në raport me Aneksin 4, progresi i raportuar nga Autoriteti i Mediave Audiovizive lidhet kryesisht me dimensionin normativ dhe rregullator, veçanërisht në drejtim të përfshirjes së standardeve të mosdiskriminimit dhe mbrojtjes së të drejtave të personave LGBTI+ në kuadrin ligjor dhe nënligjor.

Megjithatë, nuk evidentohet përmbushja e komponentëve operacionalë të këtyre masave, të cilat kërkojnë jo vetëm miratimin e standardeve, por edhe zbatimin, monitorimin dhe garantimin efektiv të tyre në praktikë. Nuk paraqiten të dhëna mbi aktivitete konkrete monitorimi të përmbajtjes mediatike në lidhje me diskriminimin ndaj personave LGBTI+, as mbi mekanizmat e ndjekjes së shkeljeve apo ndërhyrjet rregullatore në raste konkrete.

Për rrjedhojë, progresi normativ nuk rezulton i shoqëruar me mekanizma funksionalë të zbatimit, duke kufizuar ndjeshëm ndikimin real të masave të ndërmarra.

5.5.2 Vlerësimi i cilësisë së raportimit

Përgjigjja institucionale është e fokusuar pothuajse tërësisht në përshkrimin e kuadrit ligjor dhe rregullator, pa ofruar të dhëna mbi zbatimin praktik të tij.

Në mënyrë specifike:

- ! Nuk raportohen raste konkrete të monitoruara në lidhje me përmbajtje diskriminuuese;
- ! Nuk paraqiten të dhëna mbi ankesa të trajtuara, vendime të marra apo masa administrative të ndërmarra;
- ! Nuk evidentohet zhvillimi i trajnimeve për operatorët mediatikë apo aktorë të tjerë;
- ! Mungon informacion mbi burimet financiare të përdorura për zbatimin e masave;
- ! Nuk paraqiten tregues të matshëm që të lejojnë vlerësimin e progresit në përputhje me Aneksin 4.

Për rrjedhojë, pavarësisht ekzistencës së një progresi të qartë në nivel normativ, mungesa e të dhënave mbi zbatimin praktik bën që ky progres të mos konsiderohet i dokumentueshëm në kuptimin e plotë të Aneksit 4.

Vlerësimi:

Minimalisht i zbatuar ↑

5.6 Ministria e Turizmit, Kulturës dhe Sportit (MTKS)

Ministria e Turizmit, Kulturës dhe Sportit, në përgjigjen zyrtare të datës 17.12.2025, në kuadër të Ligjit nr. 119/2014 “Për të Drejtën e Informimit”, raporton mbi aktivitetet e realizuara në kuadër të masës III.1.1.e, e cila parashikon zhvillimin e një aktiviteti kulturor të përvitshëm me tematikë LGBTI+.

Institucioni informon se gjatë periudhës së monitorimit ka mbështetur një sërë aktivitesh kulturore dhe ndërgjegjësuese, të realizuara në bashkëpunim me organizata të shoqërisë civile dhe aktorë të tjerë.

Në mënyrë specifike institucioni raporton se:

- ! Në vitin 2023 është mbështetur projekti “Queer Film Marathon Tirana” (edicioni i 4-t);
- ! Në vitin 2024 është mbështetur edicioni i 5-të i këtij festivali, si dhe janë zhvilluar aktivitete sensibilizuese, përfshirë një fushatë online mbi shëndetin mendor dhe ndërgjegjësimin kundër homofobisë, transfobisë dhe bifobisë, si dhe projekte të tjera me fokus diversitetin dhe përfshirjen;
- ! Në vitin 2025 është mbështetur edicioni i 6-të i “Queer Film Marathon Tirana”, si dhe aktivitete të tjera kulturore, përfshirë diskutime publike dhe ekspozita artistike që trajtojnë tema të lidhura me diversitetin dhe identitetin.

Nga përmbajtja e përgjigjes rezulton se shumica e aktiviteteve janë organizuar nga organizata të shoqërisë civile (si OMSA dhe aktorë të tjerë), ndërsa Ministria ka pasur rol mbështetës në realizimin e tyre.

5.6.1 Vlerësimi në raport me Aneksin 4

Në raport me Aneksin 4, evidentohet një përputhje e pjesshme me masën III.1.1.e, në drejtim të mbështetjes së aktiviteteve kulturore me tematikë LGBTI+. Aktivitetet e raportuara për vitet 2023-2025 përbëjnë një kontribut të dokumentueshëm në dimensionin kulturor dhe ndërgjegjësues të Planit.

Megjithatë, nuk evidentohet realizimi i kësaj mase në mënyrë të vazhdueshme për çdo vit të periudhës së zbatimit, pasi mungon raportimi për vitin 2022, duke krijuar një boshllëk në përmbushjen e karakterit të përvitshëm të aktivitetit të parashikuar.

Gjithashtu, aktivitetet e raportuara nuk rezultojnë të jenë të iniciuara apo të strukturuar drejtpërdrejt nga vetë institucioni, por kryesisht të realizuara nga organizata të shoqërisë civile, me Ministrinë në rol mbështetës. Në këtë kuptim, kontributi institucional nuk evidentohet si një mekanizëm i qëndrueshëm dhe i institucionalizuar i zbatimit të masës.

5.6.2 Vlerësimi i cilësisë së raportimit

Përgjigjja institucionale përmban një listë të qartë aktiviteteve, por nuk është e strukturuar sipas treguesve të Aneksit 4.

Në mënyrë specifike:

- ! Nuk paraqiten të dhëna mbi numrin e pjesëmarrësve në aktivitetet e zhvilluara;
- ! Mungon informacioni mbi fondet e alokuara apo mbështetjen financiare konkrete për këto aktivitete;
- ! Nuk evidentohet ndikimi i aktiviteteve në terma të rezultateve të arritura;
- ! Nuk paraqiten tregues të matshëm që të lejojnë vlerësimin e progresit;
- ! Nuk bëhet dallim i qartë ndërmjet rolit të institucionit si organizator dhe si mbështetës në zbatimin e masave dhe aktiviteteve të raportuara.

Për rrjedhojë, megjithëse aktivitetet janë të dokumentueshme, ato nuk mund të konsiderohen plotësisht si progres i matur në kuptimin e Aneksit 4, për shkak të mungesës së të dhënave të plota dhe të strukturuar mbi treguesit dhe rezultatet e arritura.

Vlerësimi:

Minimalisht i zbatuar ↑

5.7 Ministria e Drejtësisë

Ministria e Drejtësisë, në përgjigjen zyrtare të datës 09.10.2025, në kuadër të Ligjit nr. 119/2014 “Për të Drejtën e Informimit”, raporton mbi detyrimet e saj në lidhje me përmirësimin e kuadrit ligjor dhe aksesin në drejtësi për personat LGBTI+.

Institucioni referon zhvillime në nivel strategjik dhe institucional, përfshirë faktin që ndryshimet në Kodin e Familjes janë parashikuar në dokumente strategjike dhe procese në zhvillim.

Gjithashtu, evidentohet se gjatë vitit 2024, Avokati i Popullit i është drejtuar Ministrisë me kërkesa për ndërhyrje ligjore në përputhje me Planin Kombëtar të Veprimit, duke përfshirë:

- ! Hartimin e një projektligji për identitetin gjinor;
- ! Ndryshimet në Kodin e Familjes;
- ! Ndryshimet në Ligjin për Gjendjen Civile.

Në këtë kuadër, raportohen edhe ndërveprime ndërinstucionale, përfshirë sqarime nga Ministria e Punëve të Brendshme mbi lidhjen ndërmjet ndryshimeve në Ligjin për Gjendjen Civile dhe ndërhyrjeve në Kodin e Familjes.

Në lidhje me Kodin Penal dhe adresimin e krimeve të urrejtjes, përgjigjja nuk përmban informacion mbi analiza të finalizuara apo projektpropozime konkrete për ndryshime ligjore që lidhen drejtpërdrejt me çështjet LGBTI+.

5.7.1 Vlerësimi në raport me Aneksin 4

Në raport me detyrimet e përcaktuara në Aneksin 4, nuk evidentohet përmbushja e masave kyçe që lidhen me rishikimin e kuadrit ligjor, përfshirë masën II.1.1 (Kodi Penal) dhe masën II.1.2 (Kodi i Familjes).

Përgjigjja institucionale i referohet proceseve në zhvillim dhe dokumenteve strategjike, por nuk paraqet produkte konkrete të realizuara brenda periudhës së zbatimit të Planit, siç janë projektligje të hartuara, të miratuara apo të depozituara për shqyrtim.

Gjithashtu, nuk evidentohet progres konkret në drejtim të hartimit të legjislacionit për njohjen ligjore të identitetit gjinor, bashkimeve të të njëjtit seks apo në drejtim të përmirësimit të kuadrit ligjor penal lidhur me forcimin e mbrojtjes ndaj personave LGBTI+.

5.7.2 Vlerësimi i cilësisë së raportimit

Përgjigjja institucionale është kryesisht përshkruese dhe nuk përmban të dhëna të strukturuar në raport me treguesit e Aneksit 4.

Në mënyrë specifike:

- ! Nuk paraqiten projektligje konkrete të hartuara apo të miratuara;
- ! Mungojnë të dhëna mbi progresin e matshëm të proceseve legjislative;
- ! Nuk jepen afate të qarta për përmbushjen e masave;
- ! Mungon informacion mbi burimet financiare të përdorura;
- ! Nuk evidentohet përmbushja e treguesve të Aneksit 4.

Për rrjedhojë, përgjigjja nuk lejon të provohet progres i dokumentueshëm në kuptimin e zbatimit të Planit.

Vlerësimi:

Minimalisht i zbatuar ↔

5.8 Ministria e Financave

Ministria e Financave, në përgjigjen zyrtare të datës 06.10.2025, në kuadër të Ligjit nr. 119/2014 “Për të Drejtën e Informimit”, nuk paraqet informacion mbi zbatimin e masave të Planit Kombëtar të Veprimit për Personat LGBTI+ 2021-2027.

Nga përmbajtja e përgjigjes rezulton se institucioni deklaron se nuk disponon informacionin e kërkuar dhe, në zbatim të legjislacionit për të drejtën e informimit, ka përcjellë kërkesën për trajtim pranë institucioneve të tjera që konsiderohen përgjegjëse për çështjet përkatëse, konkretisht Ministrisë së Ekonomisë dhe Inovacionit.

Përgjigjja nuk përmban asnjë informacion mbi aktivitetet e ndërmarra, masat e zbatuara apo rolin e institucionit në kuadër të Planit.

5.8.1 Vlerësimi në raport me Aneksin 4

Në raport me Aneksin 4, Ministria e Financave mbart përgjegjësi në dimensionin financiar të Planit, përfshirë masa që lidhen me mbështetjen ekonomike dhe financiare.

Megjithatë, nga përgjigjja institucionale nuk paraqiten aktivitete, produkte apo rezultate që të lidhen me përmbushjen e detyrimeve të parashikuara.

5.8.2 Vlerësimi i cilësisë së raportimit

Përgjigjja institucionale nuk përmban informacion thelbësor dhe nuk i përgjigjet në mënyrë efektive kërkesës për informacion.

Në mënyrë specifike:

- ! Nuk paraqiten të dhëna mbi asnjë masë të zbatuar;
- ! Mungon çdo referencë ndaj treguesve të Aneksit 4;
- ! Nuk jepen të dhëna mbi burimet financiare të alokuara apo të përdorura;
- ! Institucioni nuk identifikon rolin e vet në zbatimin e Planit;
- ! Përgjigjja kufizohet në përcjelljen e kërkesës tek një institucion tjetër.

Për rrjedhojë, përgjigjja nuk lejon të evidentohet asnjë nivel zbatimi apo progres i dokumentueshëm në kuptimin e Planit.

Vlerësimi:

I pazbatuar ↔

5.9 Institucionet e arsimit të lartë

5.9.1 Fakulteti i Shkencave Sociale, Universiteti i Tiranës

Fakulteti i Shkencave Sociale, Universiteti i Tiranës, në përgjigjen zyrtare të datës 10.10.2025, në kuadër të Ligjit nr. 119/2014 “Për të Drejtën e Informimit”, raporton mbi zbatimin e masës I.2.2.a të Planit Kombëtar të Veprimit për Personat LGBTI+ 2021-2027, e cila lidhet me integrimin e temave mbi çështjet LGBTI+ në kurrikulat universitare.

Institucioni informon se zhvillimi i moduleve dhe përmbajtjes së lëndëve në programet e studimit realizohet në përputhje me kornizën ligjore dhe rregulloret akademike në fuqi, si

dhe në harmoni me standardet e arsimit të lartë dhe prioritetet kombëtare në fushën e përfshirjes sociale.

Sipas përgjigjes, temat që lidhen me të drejtat e njeriut, barazinë gjinore, mosdiskriminimin dhe respektimin e diversitetit, përfshirë edhe çështjet që prekin komunitetin LGBTI+, janë të integruara në mënyrë graduale dhe ndërdisiplinore në programe studimi si Punë Sociale, Sociologji dhe Administrim i Politikës Sociale, në nivel bachelor dhe master.

5.9.1.1 Vlerësimi në raport me Aneksin 4

Në raport me Aneksin 4, masa 1.2.2.a parashikon përmirësimin e kurrikulave universitare përmes integritit të strukturuar të tematikave që lidhen me personat LGBTI+, si produkt i matshëm i zbatimit.

Megjithatë, nga përgjigjja institucionale nuk evidentohet përmbushja e këtij produkti në mënyrë të plotë. Integrimi i temave në mënyrë të përgjithshme dhe ndërdisiplinore nuk përbën domosdoshmërisht një rishikim formal të kurrikulës në kuptimin e Aneksit 4, i cili kërkon ndërhyrje të strukturuar dhe të dokumentuara në përmbajtjen akademike.

Nuk evidentohet ekzistenca e moduleve të posaçme të dedikuara për çështjet LGBTI+, as dokumentim i ndryshimeve formale në kurrikula apo në programet e studimit që të provojnë përmbushjen e masës si produkt i realizuar.

5.9.1.2 Vlerësimi i cilësisë së raportimit

Përgjigjja institucionale është e përgjithshme dhe përshkruese, pa ofruar të dhëna të strukturuar në raport me treguesit e Aneksit 4.

Në mënyrë specifike:

- ! Nuk raportohen module konkrete apo programe të rishikuara;
- ! Nuk jepen të dhëna mbi numrin e studentëve të përfshirë në këto module;
- ! Nuk evidentohet një proces formal rishikimi i kurrikulave;
- ! Mungon informacioni mbi burimet financiare të përdorura;
- ! Nuk paraqiten tregues të matshëm për vlerësimin e progresit.

Për rrjedhojë, integrimi i tematikave rezulton të jetë i karakterit të përgjithshëm dhe nuk mund të konsiderohet si progres i dokumentuar në kuptimin e plotë të Aneksit 4.

Minimalisht i zbatuar ↔**5.9.2 Fakulteti i Historisë dhe Filologjisë, Universiteti i Tiranës**

Fakulteti i Historisë dhe i Filologjisë, Universiteti i Tiranës, në përgjigjen zyrtare të datës 08.12.2025, në kuadër të Ligjit nr. 119/2014 “Për të Drejtën e Informimit”, përcjell përgjigje të konsoliduara nga disa departamente përkatëse lidhur me zbatimin e masës I.2.2.b të Planit Kombëtar të Veprimit për Personat LGBTI+ 2021-2027.

Nga përmbajtja e përgjigjeve rezulton një qasje jo e unifikuar ndërmjet departamenteve:

- ! Departamenti i Letërsisë dhe Departamenti i Gjuhësisë deklarojnë se nuk janë ngarkuar me detyra specifike në kuadër të Planit dhe nuk kanë ndërmarrë masa të strukturuar në lidhje me Aneksin 4, por theksojnë mbështetjen e përgjithshme për krijimin e një mjedisi gjithëpërfshirës dhe promovimin e respektit dhe komunikimit pa diskriminim.
- ! Departamenti i Gjeografisë raporton në mënyrë të ngjashme mungesën e detyrimeve specifike, duke theksuar përkushtimin e përgjithshëm ndaj parimeve të përfshirjes dhe gatishmërinë për të kontribuar në të ardhmen në trajtimin e çështjeve të diversitetit në mënyrë ndërdisiplinore.
- ! Departamenti i Arkeologjisë dhe Trashëgimisë Kulturore raporton trajtimin e temave që lidhen me diversitetin, gjininë dhe të drejtat e njeriut në kuadër të programeve ekzistuese, përmes lëndëve që trajtojnë kontekste sociale, kulturore dhe identitare.
- ! Departamenti i Gazetarisë dhe Komunikimit informon se temat e të drejtave të njeriut, barazisë gjinore dhe mosdiskriminimit janë të integruara në mënyrë të përgjithshme në kurrikula, përmes lëndëve që trajtojnë çështje sociale dhe juridike.

Në tërësi, përgjigjet tregojnë një trajtim të përgjithshëm të temave të diversitetit dhe mosdiskriminimit, pa referencë ndaj ndërhyrjeve specifike të lidhura drejtpërdrejt me çështjet LGBTI+ në kuadër të Planit.

5.9.2.1 Vlerësimi në raport me Aneksin 4

Në raport me Aneksin 4, masa I.2.2.b parashikon zhvillimin dhe integrimin e moduleve specifike mbi çështjet LGBTI+ në programet e shkencave të edukimit dhe disiplinave të lidhura.

Megjithatë, nga përgjigjet e departamenteve nuk evidentohet përmbushja e këtij produkti. Asnjë nga njësitë akademike nuk dokumenton:

- ! Zhvillimin e moduleve të posaçme mbi çështjet LGBTI+;
- ! Rishikim formal të kurrikulave në përputhje me kërkesat e Planit;
- ! Integrim të strukturuar dhe të dokumentuar të tematikave LGBTI+ si ndërhyrje specifike.

Trajtimi i përgjithshëm i temave të diversitetit dhe mosdiskriminimit, megjithëse relevant në plan të gjerë akademik, nuk përmbush kërkesën për ndërhyrje të targetuar dhe të matshme sipas logjikës së Aneksit 4.

5.9.2.2 Vlerësimi i cilësisë së raportimit

Përgjigjia institucionale paraqet një karakter fragmentar dhe jo të standardizuar, duke reflektuar mungesën e një qasjeje të koordinuar në nivel fakulteti.

Në mënyrë specifike:

- ! Përgjigjet ndryshojnë ndjeshëm ndërmjet departamenteve;
- ! Disa njësi deklarojnë mungesë të plotë të detyrimeve specifike;
- ! Nuk paraqiten module, programe apo dokumente të rishikuara;
- ! Nuk jepen të dhëna mbi burimet financiare të përdorura;
- ! Nuk paraqiten tregues të matshëm për vlerësimin e progresit.

Për rrjedhojë, përgjigjia nuk lejon të evidentohet progres i dokumentueshëm në kuptimin e Aneksit 4 dhe tregon mungesë të një qasjeje institucionale të strukturuar për zbatimin e kësaj mase.

Minimalisht i zbatuar ↔

5.9.3 Universiteti i Mjekësisë, Tiranë

Universiteti i Mjekësisë, Tiranë, në përgjigjen zyrtare të datës 04.11.2025, në kuadër të Ligjit nr. 119/2014 “Për të Drejtën e Informimit”, përcjell informacion nga Fakulteti i Mjekësisë dhe Fakulteti i Mjekësisë Dentare lidhur me zbatimin e Planit Kombëtar të Veprimit për Personat LGBTI+ 2021-2027.

Institucioni raporton se gjatë periudhës 2021-2025 janë ndërmarrë një sërë veprimesh në përputhje me objektivat e Planit, veçanërisht në drejtim të integritit të parimeve të barazisë, mosdiskriminimit dhe etikës profesionale në arsimin mjekësor.

Në mënyrë konkrete, raportohet:

- ! Integrimi i tematikave mbi etikën mjekësore, të drejtat e pacientit dhe mosdiskriminimin në lëndët ekzistuese të programeve të studimit;
- ! Organizimi i aktiviteteve sensibilizuese për trajtimin pa paragjykim të pacientëve, përfshirë personat LGBTI+;
- ! Krijimi i një mjedisi institucional që ndalon shprehimisht diskriminimin mbi bazë të orientimit seksual ose identitetit gjinor në politikat e brendshme;
- ! Bashkëpunimi me Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale në kuadër të trajnimeve për personelin shëndetësor mbi etikën dhe trajtimin gjithëpërfshirës.

Në lidhje me planet e ardhshme, institucioni raporton:

- ! Zgjerimin e përfshirjes së tematikave të barazisë dhe mosdiskriminimit në programet mësimore dhe në formimin e vazhduar profesional;
- ! Hartimin e udhëzimeve për komunikim etik dhe pa diskriminim me pacientët, të integruara në modulet klinike;
- ! Organizimin e ëorkshop-eve dhe aktiviteteve ndërgjegjësuere për studentët dhe stafin;
- ! Zhvillimin e studimeve kërkimore mbi aksesin në shërbimet shëndetësore për komunitetin LGBTI+ në bashkëpunim me institucione të tjera.

Institucioni gjithashtu identifikon disa vështirësi në zbatim, përfshirë mungesën e materialeve didaktike të standardizuara mbi çështjet LGBTI+, nevojën për trajnime shtesë të stafit akademik dhe koordinimin e kufizuar ndërinstitutional.

5.9.3.1 Vlerësimi në raport me Aneksin 4

Në raport me Aneksin 4, aktivitetet e raportuara lidhen me masat I.2.2.f (integrimi i tematikave në arsimin shëndetësor) dhe elementë të Objektivit I.3 (përmirësimi i aksesit në shërbime shëndetësore të ndjeshme dhe të përshtatura).

Institucioni demonstroi nivel më të lartë angazhimi krahasuar me institucionet e tjera akademike, përmes:

- ! Integrimin të tematikave relevante në përmbajtjet ekzistuese;
- ! Zhvillimit të aktiviteteve ndërgjegjësuese;
- ! Planifikimit konkret për zgjerimin e ndërhyrjeve të targetuara në të ardhmen.

Megjithatë, nuk evidentohet përmbushja e plotë e produktit të kërkuar nga Aneksi 4, pasi:

- ! Nuk dokumentohet ekzistenca e moduleve të posaçme mbi çështjet LGBTI+;
- ! Nuk paraqitet një rishikim formal dhe i miratuar i kurrikulave;
- ! Ndërhyrjet mbeten kryesisht të integruara në mënyrë të përgjithshme në strukturat ekzistuese dhe jo si produkte të veçanta dhe të matshme.

5.9.3.2 Vlerësimi i cilësisë së raportimit

Përgjigja institucionale është ndër më të plotat dhe të strukturuarat ndër të gjitha përgjigjet e marra, duke përfshirë:

- ! Përshkrim të qartë të aktiviteteve të realizuara;
- ! Identifikim të planeve të ardhshme;
- ! Reflektim mbi vështirësitë e hasura;
- ! Referencë ndaj burimeve të përgjithshme financiare (fondet e buxhetit të shtetit dhe programet e formimit të vazhduar).

Megjithatë, edhe në këtë rast:

- ! Mungojnë tregues sasiorë (numri i studentëve, trajnimeve, përfituesve);
- ! Nuk paraqiten module apo dokumente të formalizuara të kurrikulave të rishikuara;
- ! Nuk ka ndarje të qartë të burimeve financiare sipas aktiviteteve;
- ! Nuk evidentohet përmbushja e treguesve specifikë të Aneksit 4 në mënyrë të matshme.

Pjesërisht i zbatuar ↑

5.10 Avokati i Popullit

Avokati i Popullit, në përgjigjen zyrtare të datës 17.04.2026, paraqet një aktivitet të gjerë dhe të vazhdueshëm institucional në lidhje me mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të personave LGBTI+ gjatë periudhës 2020-2026.

Institucioni evidenton rolin e tij si pjesë e Aleancës Kundër Gjuhës së Urrejtjes, e themeluar në dhjetor 2019, si dhe angazhimin e vazhdueshëm në monitorimin e situatës dhe reagimin ndaj rasteve të gjuhës së urrejtjes dhe diskriminimit. Gjatë kësaj periudhe, Avokati i Popullit ka ndërhyrë në mënyrë të përsëritur përmes deklaratave publike dhe kërkesave drejtuar institucioneve përgjegjëse, veçanërisht në raste të dhunës ndaj anëtarëve të komunitetit dhe përdorimit të gjuhës së urrejtjes.

Nga monitorimi i tij, institucioni konstaton rritje të gjuhës së urrejtjes dhe kërcënimeve, sidomos gjatë viteve 2023-2024 dhe në mënyrë të theksuar gjatë aktiviteteve të lidhura me IDAHOT 2024, si dhe pas ceremonisë simbolike të 21 majit 2024. Gjithashtu, gjatë periudhës gusht-nëntor 2025 evidentohet një rritje e ndjeshme e dezinformimit dhe narrativave stigmatizuese në kontekstin e miratimit të ligjit “Për barazinë gjinore”, e shoqëruar me sulme ndaj organizatave të shoqërisë civile dhe aktivistëve.

Në drejtim të promovimit dhe ndërgjegjësimit, Avokati i Popullit raporton pjesëmarrje të vazhdueshme në aktivitete publike dhe fushata ndërgjegjësuese, përfshirë aktivitetet e organizuara në kuadër të IDAHOT në vite të ndryshme, si dhe bashkëpunime me organizata të shoqërisë civile dhe institucione të tjera.

Institucioni raporton një angazhim të qëndrueshëm në ngritjen e kapaciteteve të brendshme dhe ndërinstucionale, përmes trajnimeve të organizuara për stafin, përfshirë ndihmëskomisionerët dhe zyrat rajonale, si dhe përmes bashkëpunimeve me organizata dhe partnerë ndërkombëtarë.

Një komponent i rëndësishëm i aktivitetit të raportuar, lidhet me rolin monitorues dhe inspektues të institucionit. Në korrik 2023, Avokati i Popullit ka inspektuar Qendrën Streha dhe ka nxjerrë rekomandime konkrete për përmirësimin e standardeve të funksionimit, duke përfshirë rritjen e financimit, përmirësimin e kushteve materiale dhe sigurimin e një infrastrukture të qëndrueshme. Nga ndjekja e këtyre rekomandimeve rezulton se disa institucione përgjegjëse kanë ndërmarrë masa në drejtim të zbatimit të tyre, përfshirë ngritjen e grupeve të punës dhe kryerjen e inspektimeve përkatëse.

Në fushën legjislativë, Avokati i Popullit raporton ndërhyrje të rëndësishme me iniciativë, duke iu drejtuar institucioneve përgjegjëse për ndërmarrjen e ndryshimeve ligjore të parashikuara në Plan, përfshirë projektligjin për identitetin gjinor, ndryshimet në Kodin e Familjes dhe në Ligjin për Gjendjen Civile. Gjithashtu, institucioni ka trajtuar raste konkrete me ndikim strategjik, përfshirë hartimin e një opinionimi Amicus Curiae në lidhje me njohjen e

prindërimin të dy nënave dhe analizën e një nisme ligjore që synonte kufizimin e të drejtave të personave transgjinjorë.

5.10.1 Vlerësimi në raport me Aneksin 4

Aktiviteti i raportuar nga Avokati i Popullit lidhet kryesisht me objektivat që kanë të bëjnë me mbrojtjen ligjore, aksesin në drejtësi dhe promovimin e një shoqërie gjithëpërfshirëse. Institucioni paraqet nivelin më të lartë të angazhimit ndër të gjitha institucionet raportuese, veçanërisht në drejtim të monitorimit të situatës së të drejtave të njeriut, reagimit ndaj shkeljeve dhe ndjekjes së rekomandimeve ndaj institucioneve të tjera.

Megjithatë, ky angazhim nuk paraqitet i strukturuar në mënyrë të drejtpërdrejtë sipas logjikës së ndërhyrjes dhe treguesve të Aneksit 4. Aktivitetet e raportuara, ndonëse thelbësore dhe me ndikim, nuk dokumentohen si përmbushje e matshme e masave specifike të Planit, por më tepër si ushtrim i funksioneve të përgjithshme të institucionit në fushën e mbrojtjes së të drejtave të njeriut.

5.10.2 Vlerësimi i cilësisë së raportimit

Përgjigjja e Avokatit të Popullit është ndër më të detajuarat dhe më thelbësoret ndër të gjitha përgjigjet e marra, duke përfshirë përshkrime konkrete të aktiviteteve, rasteve dhe ndërhyrjeve institucionale. Ajo ofron një panoramë të qartë të rolit aktiv të institucionit në monitorimin dhe promovimin e të drejtave të personave LGBTI+.

Megjithatë, raportimi nuk ndjek strukturën e Aneksit 4, nuk përfshin tregues të standardizuar dhe nuk jep informacion mbi burimet financiare të përdorura. Këto elemente do të lejonin matjen e drejtpërdrejtë dhe më të detajuar të progresit në raport me zbatimin e masave të Planit.

Vlerësimi:

Pjesërisht i zbatuar ↑

6. ANALIZA E ZBATIMIT TË LOGJIKËS NDËRHYRËSE TË PKV-SË: NJËSITË E VETËQEVERISJES VENDORE

Sipas Aneksit 4 të Planit Kombëtar të Veprimit për Personat LGBTI+ 2021-2027, njësitë e vetëqeverisjes vendore mbartin një rol kyç në zbatimin e disa prej masave më të drejtpërdrejta në nivel komunitar. Këto masa përfshijnë trajnimin e nëpunësve për barazinë gjinore dhe koordinatoreve vendorë (masa I.1.1.d), ngritjen e kapaciteteve të ekipeve teknike ndërdisiplinare të mekanizmave të koordinuar të referimit kundër dhunës në familje në nivel bashkie, si dhe të punonjësve të NJMF-ve (masa I.1.2.c), adresimin e nevojave për strehim përmes instrumenteve si bonusi i qirasë (masa I.1.3.c), si dhe miratimin dhe zbatimin e politikave vendore kundër diskriminimit (masa III.2.1.e).

Në kuadër të këtij monitorimi, janë dërguar kërkesa zyrtare për informacion në 61 bashkitë e vendit. Deri në momentin e hartimit të raportit, janë marrë gjithsej 10 përgjigje, të cilat korrespondojnë me 9 bashki, pasi njëra bashki (Bashkia Elbasan) ka përcjellë dy përgjigje të ndara. Kjo do të thotë se mbi 83% e bashkive nuk kanë kthyer asnjë përgjigje mbi nivelin e zbatimit të PKV-së, brenda afatit ligjor.

Kjo mungesë masive e përgjigjeve përbën një gjetje kritike të vetë monitorimit dhe reflekton nivel të ulët transparence dhe llogaridhënieje institucionale në nivel vendor. Në të njëjtën kohë, ajo përbën edhe një kufizim të rëndësishëm në thellësinë e analizës.

Për këtë arsye, ky raport synon të ofrojë një vlerësim të përgjithshëm të nivelit të zbatimit të PKV-së në nivel vendor, bazuar në informacionin e disponueshëm, dhe jo një analizë të detajuar dhe të individualizuar për secilën bashki. Në këtë kuadër metodologjik, përgjigjet e marra janë trajtuar në mënyrë të konsoliduar dhe janë reflektuar në formë tabelare, duke mundësuar një krahasim të strukturuar ndërmjet bashkive dhe identifikimin e tendencave kryesore të zbatimit të logjikës ndërhyrëse të Aneksit 4.

6.1 Gjetje të përgjithshme

Analiza e përgjigjeve të marra nga bashkitë evidenton një nivel të ulët dhe të fragmentar të zbatimit të masave të Planit, si dhe mungesë të një qasjeje të strukturuar dhe proaktive në nivel vendor.

Në mënyrë të përsëritur, bashkitë nuk raportojnë ekzistencën e një buxheti të dedikuar për zbatimin e masave të PKV-së, çka tregon se dimensionin financiar i Planit nuk është integruar

në planifikimin buxhetor në nivel vendor. Po ashtu, nuk evidentohet ngritja apo trajnimi i pikave fokale për çështjet LGBTI+, siç kërkohet nga logjika e ndërhyrjes së Planit.

Një element i rëndësishëm dhe problematik është arsytimi i përdorur nga disa bashki, të cilat lidhin moszbatimin e masave të PKV-së me mungesën e “rasteve të deklaruara të personave LGBTI+”. Ky qëndrim bie ndesh me natyrën e Planit, i cili synon ndërtimin e kapaciteteve institucionale dhe krijimin e mekanizmave të aksesit efektiv në shërbime dhe mbrojtjes së personave LGBTI+, pavarësisht numrit të personave që kanë dalë hapur.

Në tërësi, aktivitetet e raportuara janë kryesisht deklarative dhe nuk shoqërohen me të dhëna statistikore, tregues të matshëm apo dokumentacion mbështetës, duke kufizuar ndjeshëm mundësinë për të vlerësuar progresin në përputhje me Aneksin 4.

Veçanërisht, rezulton se:

- ! Asnjë bashki nuk raporton buxhet të dedikuar për zbatimin e masave të PKV-së;
- ! Asnjë bashki nuk raporton pika fokale për çështjet LGBTI+ të ngritura ose të trajnuara;
- ! Shumica e bashkive arsyetojnë moszbatimin e logjikës ndërhyrëse të PKV-së, me mungesën e rasteve të personave që dalin hapur, arsyetim që bie ndesh me natyrën proaktive dhe parandaluese të PKV-së;
- ! Aktivitetet e raportuara janë kryesisht deklarative, pa statistika, tregues ose dokumentacion mbështetës.

6.2 Tabela e konsoliduar e gjetjeve të monitorimit në nivel vendor

Bashkia	Zbatimi i masave kryesore (sipas Aneksit 4)	Aktivitetet e raportuara	Boshllëqe kryesore	Vlerësimi i zbatimit	Trendi	Buxhet i dedikuar për Planin Kombëtar të Veprimit
Bashki që kanë raportuar aktivitete me lidhje të pjesshme me logjikën ndërhyrëse të Planit Kombëtar të Veprimit LGBTI+ 2021-2027						

Bashkia	Zbatimi i masave kryesore (sipas Aneksit 4)	Aktivitetet e raportuara	Boshllëqe kryesore	Vlerësimi i zbatimit	Tren di	Buxheti i dedikuar për Planin Kombëtar të Veprimit
Elbasan	Referencë ndaj disa masave të Aneksit 4 (trajnim, politika sociale); ekzistencë e sektorit kundër diskriminimit	Aktivitete sensibilizuese; ndërhyrje institucionale; strukturë e dedikuar për mbrojtjen nga diskriminimi; referencë ndaj planifikimit buxhetor për 2026-ën	Nuk evidentohet zbatim sipas treguesve të Aneksit 4; mungojnë të dhënat numerike; asnjë buxheti i dedikuar për zbatimin e Planit Kombëtar të Veprimit	Minimalisht i zbatuar	↑	Jo
Lezhë	Lidhje më e qartë e përgjigjes institucionale me masat I.1.1.d dhe I.1.2.c të Aneksit 4 (trajnim i Njesisë për	Trajnime për ekipet e Mekanizmit të Koordinuar të Referimit dhe nëpunësit për barazinë gjinore; referim ndaj mekanizmave ekzistuese	Nuk raportohen rezultate të matshme sipas Aneksit 4; mungon informacioni mbi komponentin e strehimit	Minimalisht i zbatuar	↑	Jo

Bashkia	Zbatimi i masave kryesore (sipas Aneksit 4)	Aktivitetet e raportuara	Boshllëqe kryesore	Vlerësimi i zbatimit	Tren di	Buxhet i dedikuar për Planin Kombëtar të Veprimit
	Barazi Gjinore dhe i Mekanizmit të Koordinuar të Referimit)		dhe politikat e formalizuara kundër diskriminimit			
Shkodër	Referencë e përgjithshme ndaj ofrimit të shërbimeve pa diskriminim	Shërbime pa diskriminim; disa aktivitete ndërgjegjësuese dhe trajnime të kufizuara mbi barazinë dhe mosdiskriminimin	Nuk ka lidhje direkte me masat e Aneksit 4; mungojnë treguesit e qartë, strukturimi dhe buxheti i dedikuar	Minimalisht i zbatuar	↔	Jo
Kuçovë	Nuk evidentohet lidhje direkte e përgjigjes institucionale me	Aktivitet minimal ndërgjegjësues; përfshirje sporadike e tematikave të barazisë dhe	Asnjë trajnim sistematik mbi çështjet LGBTI+; mungesë strukturash	Minimalisht i zbatuar	↔	Jo

Bashkia	Zbatimi i masave kryesore (sipas Aneksit 4)	Aktivitetet e raportuara	Boshllëqe kryesore	Vlerësimi i zbatimit	Trendi	Buxheti i dedikuara për Planin Kombëtar të Veprimit
	masat specifike të Planit Kombëtar të Veprimit	mbrojtjes nga diskriminimi	të dedikuara, treguesish dhe ndërhyrjesh të qëndrueshme			
Mallakastër	Nuk evidentohet zbatimi i masave të Aneksit 4	Përgjigje deklarative mbi parimet e përfshirjes dhe mosdiskriminimit	Asnjë aktivitet konkret i dokumentuar; mungesë treguesish dhe veprimesh të matshme	Minimalisht i zbatuar	↔	Jo
Bashki me mungesë të përgjithshme të zbatimit të PKV-së						
Peqin	Nuk evidentohet zbatimi	Institucioni konfirmon mungesë aktivitetesh konkrete	Mungesë e plotë ndërhyrjeve; mungesë strukturash, trajnimesh dhe politikash	I pazbatuar	↓	Jo

Bashkia	Zbatimi i masave kryesore (sipas Aneksit 4)	Aktivitetet e raportuara	Boshllëqe kryesore	Vlerësimi i zbatimit	Trendi	Buxheti i dedikuar për Planin Kombëtar të Veprimit
Belsh	Nuk evidentohet zbatim	Justifikim i mosveprimit me mungesën e rasteve të personave që dalin hapur si LGBTI+	Qasje plotësisht reaktive; moskuptim i natyrës parandaluese të Planit Kombëtar të Veprimit	I pazbatuar	↓	Jo
Vorë	Nuk evidentohet zbatim	Nuk raportohen aktivitete konkrete	Mungesë e plotë masash proaktive; asnjë strukturë apo ndërrhyrje e dokumentuar	I pazbatuar	↓	Jo
Himarë	Nuk evidentohet zbatim	Justifikim i mosveprimit me mungesën e rasteve të personave që dalin hapur si LGBTI+	Qasje reaktive; mungesë e plotë e implementimit praktik	I pazbatuar	↓	Jo

Bashkia	Zbatimi i masave kryesore (sipas Aneksit 4)	Aktivitetet e raportuara	Boshllëqe kryesore	Vlerësimi i zbatimit	Trendi	Buxheti i dedikuar për Planin Kombëtar të Veprimit
Bashki që nuk kanë kthyer përgjigje						
52 bashki	Nuk ka informacion	Nuk kanë kthyer përgjigje	Mungesë e plotë transparencë dhe llogaridhënieje	Pa informacion	-	-
Legjenda: I pazbatuar Minimalisht i zbatuar Pa informacion Trendi: ↑ përmirësim ↔ pandryshueshmëri ↓ përkeqësim						

7. KONTRIBUT MONITORUES NGA QENDRA STREHA

Qendra Streha përbën shërbimin e vetëm të specializuar rezidencial për personat LGBTI+ në Shqipëri dhe është një aktor kyç në ofrimin e shërbimeve direkte dhe në monitorimin praktik të aksesit në to. Megjithëse nuk është institucion publik, Qendra Streha operon me financim të pjesshëm nga buxheti i shtetit dhe është e përfshirë drejtpërdrejt në logjikën e ndërhyrjes së Planit Kombëtar të Veprimit, veçanërisht në lidhje me shërbimet rezidenciale dhe mbështetjen sociale të anëtarëve të komunitetit LGBTI+, që bien në kontakt me shërbimin e ofruar nga kjo qendër.

Për këtë arsye, të dhënat e ofruara nga Qendra Streha nuk trajtohen si raportim institucional publik, por si kontribut monitorues i pavarur, i cili ofron një pasqyrë të matshme dhe të bazuar në të dhëna të zbatimit real të disa treguesve të Aneksit 4. Në kontrast me përgjigjet e institucioneve publike, ky kontribut paraqet të dhëna sasiore dhe zhvillime konkrete mbi aksesin në shërbime, duke plotësuar një hendek të rëndësishëm informacioni në këtë raport.

7.1 Trajnimet e profesionistëve (treguesit I.1.1.b, I.1.2, I.3.1.b)

Të dhënat e raportuara nga Qendra Streha tregojnë një rritje progresive të numrit të profesionistëve të trajnuar nga kjo qendër gjatë viteve 2021-2024, nga rreth 30 profesionistë në fillim të periudhës raportuese në rreth 150-200 profesionistë në vitet e mëvonshme. Trajnimet janë zhvilluar në disa qytete të vendit dhe kanë përfshirë kryesisht ofrues shërbimesh sociale, staf të bashkive, qendra komunitare dhe organizata jofitimprurëse, shpesh të shoqëruara me aktivitete ndërgjegjësuere dhe mentorim.

Viti	Profesionistë të trajnuar	Qytetet / Konteksti	Detajet
2020-21	~30	Kryesisht qendra sociale	Në fokus shërbimet sociale dhe institucionet vendore
2022	~100	Shkodër, Fier, Berat, Korçë	Trajnim dhe mentorim; bashkëpunim me strukturat vendore
2023	~200	Lezhë, Kamëz, Vlorë, Pogradec	20 ofrues shërbimesh të specializuar mbi HIV/SST; aktivitete ndërgjegjësuere

2024	~150	Strukturat e bashkive, qendra komunitare	Në fokus rritja e aksesit në shërbime komunitare dhe bashkëpunimi ndërsektorial
-------------	-------------	--	---

7.2 Shërbimet SST/HIV (treguesi I.3.2.e)

Të dhënat mbi aksesin në shërbimet e testimit për SST/HIV të mbështetura nga qendra Streha tregojnë një ulje gjatë periudhës së raportimit. Pas një niveli testimesh të ofruara relativisht të qëndrueshëm në vitet 2021-2023, evidentohet një rënie e ndjeshme në vitin 2024 dhe një kolaps praktik në vitin 2025, me vetëm një shërbim të raportuar. Kjo situatë lidhet drejtpërdrejt me ndërprerjen e shërbimit të testimit të shpejtë (rapid test) dhe kalimin në një sistem më të fragmentuar institucional, i cili përfshin një zinxhir kompleks referimi ndërmjet institucioneve shëndetësore. Si pasojë, evidentohet rritje e barrierave administrative, mungesë koordinimi ndërinstitutional dhe orientim i përfituesve drejt sektorit privat, duke kufizuar aksesin efektiv në shërbime.

Viti	Shërbime SST/HIV	Detaje
2021	8	
2022	9	
2023	8	
2024	4	
2025	1/KOLAPS PRAKTIK	

7.3 Financimi shtetëror i shërbimit rezidencial (treguesi I.1.b: rritje 1%/vit)

Të dhënat mbi financimin shtetëror të shërbimit rezidencial, tregojnë se mbështetja nga Fondi Social për Qendrën Streha ka shënuar rritje progresive gjatë periudhës 2021-2025, duke përbushur dhe në disa raste tejkaluar objektivin e Planit për rritje vjetore prej 1%.

Megjithatë, kjo tendencë pozitive është ndërprerë në periudhën 2025-2026, ku nuk evidentohet asnjë rritje e financimit. Në të njëjtën kohë, nuk rezulton e realizuar masa që

lidhet me zgjerimin e shërbimeve rezidenciale në qarqe të tjera, duke treguar se progresi në financim nuk është shoqëruar me zgjerim proporcional të kapaciteteve të shërbimit.

Periudha	Rritja (%)	Statusi ndaj targetit (+1%/vit)
2021-22	+1.03%	Target i arritur
2022-23	+1.02%	Target i arritur
2023-24	+1.09%	Target i arritur
2024-25	+1.5%	Target i tejkaluar
2025-26	0%	Target i pamundur; shtrirja në dy qarqe të tjera (I.1.3.b) e pazbatuar

7.4 Përfundime

Kontributi i Qendrës Streha tregon një hendek të qartë ndërmjet raportimit institucional dhe realitetit të zbatimit të masave të planifikuara në terren. Ndërkohë që institucionet publike në përgjithësi nuk paraqesin të dhëna të matshme, të dhënat e raportuara nga Qendra Streha tregojnë qartë se progresi në disa fusha është i kufizuar dhe i paqëndrueshëm, ndërsa në fusha të tjera ka regres të dukshëm.

Ky kontribut thekson veçanërisht:

- ! Mungesën e zbatimit të treguesve kyç të Aneksit 4 në sektorin shëndetësor;
- ! Varësinë e zbatimit të masave të planifikuara nga aktorë jo-shtetërorë;
- ! Fragmentimin e sistemit të ofrimit të shërbimeve; dhe
- ! Mungesën e një qasjeje të koordinuar dhe të qëndrueshme institucionale.

Në këtë kuptim, të dhënat e Qendrës Streha përbëjnë një nga burimet më të rëndësishme për vlerësimin real të zbatimit të Planit, duke ofruar një perspektivë të bazuar në të dhëna, që shpesh mungon në raportimet e institucioneve publike.

8. KONTRIBUT MONITORUES NGA ALEANCA KUNDËR DISKRIMINIMIT LGBTI

Aleanca Kundër Diskriminimit LGBTI ka kontribuar në këtë raport monitorimi përmes ndarjes së të dhënave të mbledhura gjatë periudhës 2021-2025 në kuadër të ushtrimit të veprimtarisë së saj, aktiviteteve monitoruese, shërbimeve direkte të ofruara për personat LGBTI+ dhe ndërhyrjeve të ushtruara nga organizata. Ky kontribut nuk ka karakterin e

raportimit institucional publik, por trajtohet si burim i pavarur informacioni nga shoqëria civile, i cili ofron të dhëna empirike dhe tregues praktikë mbi nivelin real të zbatimit të logjikës ndërhyrëse të Planit Kombëtar të Veprimit për Personat LGBTI+ 2021-2027, veçanërisht lidhur me masat e parashikuara për ngritjen e kapaciteteve institucionale, aksesin në shërbime shëndetësore dhe sociale, ndihmën juridike, diskriminimin në arsim dhe funksionimin praktik të mekanizmave të referimit dhe mbështetjes për komunitetin LGBTI+.

8.1 Trajnimet dhe ngritja e kapaciteteve të profesionistëve

Viti	Aktivitetet kryesore	Të dhëna kryesore	Gjetje / detaje
2021	Trajnime për nëpunës vendorë dhe oficerë policie	~50 nëpunës vendorë (Tiranë, Vlorë, Lezhë); ~100 oficerë policie	
2022	Trajnime në sektorin arsimor	20 mësues; 20 psikologë shkollorë	Mungesë e moduleve të specializuara
2023	Trajnime për bashkitë dhe shërbimet sociale	71 profesionistë vendorë në Korçë, Elbasan, Lezhë dhe Tiranë	Rritje njohurish, rreth 28-35% pas trajnimeve
2024	Trajnime për profesionistë të ligjit dhe magjistratë	38 profesionistë të ligjit; 26 magjistratë të rinj	Rritje njohurish, rreth 38% mbi standardet ligjore të trajtimit dhe adresimit të çështjeve LGBTI+
2024	Trajnime për shërbimet sociale vendore	71 punonjës bashkiakë dhe të shërbimeve sociale	Rritje mesatare njohurish, rreth 32% pas trajnimeve

Përveç aktiviteteve trajnuese, Aleanca LGBT raporton analiza të 12 teksteve shkollore dhe zhvillimin e manualit “School Safe Kit”, me fokus në adresimin e bullizmit dhe përfshirjen e çështjeve LGBTI+ në mjedisin arsimor.

8.2 Aksesi në shërbime shëndetësore dhe testimet për SST/HIV

Viti	Testime HIV/SST	Këshillim / Outreach	Gjetje kryesore
------	-----------------	----------------------	-----------------

2021	1131 testime	101 persona këshillim mbi HIV/AIDS	Mungesë e PrEP/PEP dhe e testeve të avancuara
2022	1485 testime	2256 persona MSM të arritur; 59,109 prezervativë të shpërndarë	Barrierë e lartë aksesi në shërbime dhe testime jashtë Tiranës
2023	1538 testime	2535 persona MSM të arritur	4 raste të identifikuar HIV pozitiv; 2 me Hepatit B; 4 sifiliz pozitiv
2024	1589 testime	Shërbime anonime dhe këshillim individual	107 raste kanë kërkuar ndërmjetësim për trajtim korrekt mjekësor
2025	Ndërprerje e shërbimit të testimi në qendër	35 raste shoqërimi dhe referimi shëndetësor	Marrja e shërbimeve shëndetësore mbetet e varur nga ndërmjetësimi i OJQ-ve

Të dhënat tregojnë se organizatat e shoqërisë civile kanë luajtur rol thelbësor në sigurimin praktik të aksesit në shërbime shëndetësore dhe testim për komunitetin LGBTI+ gjatë periudhës monitoruese, në mungesë të një qasjeje publike të integruar dhe gjithëpërfshirëse.

Megjithatë, përgjatë gjithë periudhës së raportimit, nga Aleanca LGBTI evidentohen problematika të vazhdueshme, duke përfshirë:

- ! Mungesën e shërbimeve mjekësore afirmuese për personat transgjinjorë;
- ! Mungesën e trajnimit të profesionistëve të shëndetësisë;
- ! Diskriminimin dhe frikën e qëndrueshme nga ekspozimi në institucionet publike;
- ! Barrierat ekonomike në aksesin e shërbimeve;
- ! Nevojën e vazhdueshme për shoqërim dhe ndërmjetësim të individëve LGBTI+ nga organizatat e shoqërisë civile, për të garantuar trajtimin korrekt të tyre.

8.3 Shërbimet sociale, juridike dhe mbështetja direkte për personat LGBTI+

Viti	Shërbime dhe mbështetje direkte	Gjetje kryesore
------	---------------------------------	-----------------

2022	520 shërbime përmes platformës SOS LGBTI; 407 seanca psikologjike; 37 këshillime ligjore; 10 raste strehimi emergjent; 140 paketa ushqimore; 52 raste referimi institucional; 86 raste ndërmjetësimi për akses në shërbime	Nevojë e lartë për mbështetje bazike, strehim dhe ndërmjetësim institucional
2023	463 seanca psikologjike; 49 këshillime ligjore; 15 raste strehimi emergjent; 61 raste referimi institucional; 97 raste ndërmjetësimi për akses në shërbime; mbështetje komunitare për persona LGBTI+ në disa bashki	Evidentohet rezistencë institucionale në disa bashki, veçanërisht në bashkinë Fier
2024	518 seanca psikologjike; 102 këshillime ligjore; 22 raste strehimi emergjent; 74 raste referimi institucional; 107 raste ndërmjetësimi në institucione shëndetësore dhe sociale; zgjerim i mbështetjes psikosociale dhe juridike	Diskriminimi vazhdon në shëndetësi, punësim dhe strehim; rritje e kërkesës për shërbime komplekse
2025	155 sesione këshillimi ligjor; 12 seanca gjyqësore; 4 procedura pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi; 35 raste shoqërimi dhe ndërmjetësimi institucional; rritje e rasteve që lidhen me diskriminimin, të drejtat familjare, identitetin gjinor, migrimin dhe azilin	Rritje me 52% e shërbimeve ligjore të ofruara, krahasuar me vitin 2024; intensifikim i nevojës për mbështetje juridike dhe institucionale

Të dhënat tregojnë një rritje progresive të kërkesës për shërbime psikosociale, juridike dhe mbështetje direkte, veçanërisht në rastet komplekse që lidhen me diskriminimin, njohjen ligjore, familjen, migrimin dhe azilin.

Në të njëjtën kohë, raportet e Aleancës evidentojnë se organizatat e shoqërisë civile vijnë të mbulojnë në praktikë një pjesë të konsiderueshme të funksioneve mbështetëse që PKV-ja ua atribuon institucioneve publike.

8.4 Gjetje kryesore mbi zbatimin e PKV-së

Tregues / Gjetje	Evidentimi
Diskriminimi	98% e komunitetit raportojnë përvoja diskriminimi
Raportimi i rasteve të dhunës dhe diskriminimit	Vetëm 7.1% raportojnë rastet në institucionet e sistemit të sigurisë dhe drejtësisë

Emigrimi	79% kanë konsideruar largimin nga Shqipëria
Informimi ligjor	45.1% nuk janë të informuar mbi mbrojtjen ligjore
Arsimi	~70% e nxënësve kanë dëshmuar gjuhë urrejtjeje në shkolla
Siguria në shkolla	~30% janë ndjerë të pasigurt dhe kanë menduar të lënë shkollën
Shëndetësia	Diskriminim dhe mungesë e shërbimeve të specializuara, sidomos për personat transgjinjorë
Institucionet	Mungesë koordinimi ndërinstytucional dhe zbatim i ulët i logjikës ndërhyrëse të PKV-së

Për vitin 2025, Aleanca evidenton gjithashtu zhvillime të rëndësishme pozitive, përfshirë miratimin e Ligjit nr. 64/2025 “Për Barazinë Gjinore”, tërheqjen e amendamenteve regressive të propozuara në lidhje me Ligjin nr. 10129/2009 “Për gjendjen civile” dhe disa vendime pozitive të institucionave të pavarura në raste diskriminimi dhe gjuhe urrejtjeje.

Megjithatë, në tërësi, gjetjet e raportuara konfirmojnë ekzistencën e një hendeku të konsiderueshëm ndërmjet kuadrit strategjik të PKV-së dhe nivelit real të aksesit në të drejta dhe shërbime për personat LGBTI+ në Shqipëri. Njëkohësisht, ato evidentojnë rolin thelbësor që organizatat e shoqërisë civile vazhdojnë të luajnë në kompensimin e boshllëqeve të zbatimit institucional të Planit.

9. KONTRIBUT MBËSHTETËS NGA KËSHILLI I EVROPËS

Këshilli i Evropës, përmes komunikimit zyrtar të dates 30.04.2026, paraqet një përmbledhje të kontributit të tij në mbështetje të hartimit dhe zbatimit të Planit Kombëtar të Veprimit për Personat LGBTI+ 2021-2027, gjatë periudhës 2021-2025.

Kontributi i raportuar lidhet kryesisht me asistencën teknike, ngritjen e kapaciteteve dhe mbështetjen institucionale, të ofruara në kuadër të projektit të përbashkët të Bashkimit Evropian dhe Këshillit të Evropës. Në fazën e hartimit të Planit, ky bashkëpunim ka përfshirë mbështetje për Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale në vlerësimin e Planit të mëparshëm (2016-2020), si dhe ofrimin e ekspertizës dhe rekomandimeve konkrete gjatë procesit të draftimit të Planit aktual.

Në drejtim të ngritjes së kapaciteteve të profesionistëve, Këshilli i Evropës raporton organizimin e një cikli trajnimesh për mbi 140 përfaqësues të policisë në vitin 2021, si dhe

trajnime të mëvonshme për studentë të Akademisë së Sigurisë, gjyqtarë, prokurorë dhe përfaqësues të institucioneve të drejtësisë gjatë viteve 2023-2024. Gjithashtu, rreth 30 përfaqësues të sistemit të drejtësisë kanë përfunduar kursin HELP mbi krimet e urrejtjes në vitin 2024.

Një komponent i rëndësishëm i kontributit lidhet me mbështetjen për hartimin e protokollit shëndetësor për personat transgjinjorë, përmes bashkëpunimit me Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale dhe Njësinë SOGIESC të Këshillit të Evropës në Strasburg. Ky proces ka përfshirë organizimin e grupeve të punës dhe ofrimin e ekspertizës teknike, ndërkohë që protokollin mbetet ende në proces miratimi.

Këshilli i Evropës raporton gjithashtu mbështetje të vazhdueshme për aktivitetet ndërgjegjësuese në kuadër të muajit të krenarisë, përmes financimit të organizatave të shoqërisë civile për realizimin e iniciativave promovuese të të drejtave të personave LGBTI+.

Në vitin 2023 është realizuar gjithashtu një monitorim i ndërmjetëm i zbatimit të Planit, në bashkëpunim me institucionet përgjegjëse.

9.1 Kontributi në raport me Aneksin 4

Kontributi i Këshillit të Evropës lidhet në mënyrë të tërthortë me një sërë masash të Aneksit 4, veçanërisht në drejtim të ngritjes së kapaciteteve të profesionistëve të drejtësisë dhe sigurisë, si dhe mbështetjes për zhvillimin e instrumenteve specifike në sektorin shëndetësor.

Megjithatë, roli i këtij institucioni mbetet mbështetës dhe jo zbatues kryesor. Aktivitetet e raportuara përfaqësojnë ndërhyrje të rëndësishme në nivel teknik dhe profesional, por nuk përbëjnë në vetvete përmbushje të drejtpërdrejtë të detyrimeve të institucioneve shqiptare sipas Planit.

Në këtë kuptim, kontributi i Këshillit të Evropës ka mundësuar zhvillimin e kapaciteteve dhe avancimin e disa proceseve të rëndësishme në kuadër të realizimit të logjikës ndërhyrëse të Planit, por nuk garanton automatikisht zbatimin efektiv të masave në nivel institucional.

10. PERSPEKTIVA E KOMUNITETIT LGBTI+

Kjo pjesë e raportit bazohet në analizën e pyetësorëve vjetorë të realizuar nga Aleanca LGBTI gjatë gjithë periudhës së raportimit, duke siguruar një ndjekje të vazhdueshme të përvojës së komunitetit në lidhje me aksesin në të drejta, shërbime dhe mbrojtje nga diskriminimi. Në mënyrë të veçantë, analiza mbështetet në të dhënat e mbledhura përgjatë viteve 2021-2025, të cilat përfaqësojnë një burim të qëndrueshëm dhe të shtrirë në kohë të informacionit.

Përdorimi i këtyre gjetjeve mundëson një krahasim të drejtpërdrejtë me gjendjen bazë të evidentuar në periudhën 2020-2024, duke lejuar identifikimin e drejtimit të progresit (↑ përmirësim; ↔ pandryshueshmëri; ↓ përkeqësim) për një sërë treguesish kyç që lidhen me aksesin në strehim, shëndetësi, punësim, siguri dhe me rastet e diskriminimit. Kjo qasje krahasimore i jep analizës një dimension të thelluar, pasi nuk fokusohet vetëm në situatën aktuale, por edhe në evoluimin e treguesve ndër vite.

Ndryshe nga raportimet institucionale, të cilat në shumë raste rezultojnë të përgjithshme dhe të pamjaftueshme në tregues të matshëm, të dhënat nga komuniteti ofrojnë një perspektivë të drejtpërdrejtë mbi ndikimin real të politikave institucionale dhe masave të ndërmarra për zbatimin e Planit. Për këtë arsye, ato përbëjnë një komponent thelbësor të këtij monitorimi, duke ndihmuar në qartësimin e hendekut ndërmjet zbatimit formal të Planit dhe realitetit të përjetuar nga personat LGBTI+ në jetën e përditshme.

Në këtë kuptim, perspektiva e komunitetit nuk trajtohet vetëm si burim plotësues informacioni, por si një element kritik për vlerësimin e efektivitetit të Planit Kombëtar të Veprimit dhe për identifikimin e fushave ku ndërhyrja institucionale mbetet e pamjaftueshme ose joefektive.

10.1 Treguesit kryesorë (krahasim i periudhave 2020-2024 dhe 2024-2025)

Treguesi	2020-24	2024-25	↑↔↓	Lidhja me PKV-në
Shqetësimi për mungesën e njohjes ligjore, si shkak që nxit qëllimin për emigrim	68%	74%	↓	Objektivat II.1.2-II.1.3

Diskriminimi në shëndetësi	22%	26.9%	↓	Objektivi I.3
Diskriminimi në punësim	30%	32%	↓	Objektivat I.4, III.2
Pasiguria në strehim	42%	48.7%	↓	Objektivi I.1.3
Dëshira për emigrim	65%	88%	↓	Tregues i përgjithshëm
Bullizmi në shkollë	51%	52.4%	↓	Objektivi I.2 (arsim)
Njohja e rolit të KMD-së	-	36%	↔	Objektivi II.2
Besimi tek institucionet ligjzbatuese	-	12%	↔	Objektivat II.1-II.2
Viktima që nuk raportojnë krimet e urrejtjes dhe rastet e diskriminimit	80%	85%	↓	Objektivat II.2.2
Njohja e PKV-së nga komuniteti	-	22%	↔	Tregues i përgjithshëm

10.2 Akses në Shëndetësi

Të dhënat nga komuniteti tregojnë se akses në shërbimet shëndetësore mbetet i kufizuar dhe i pabarabartë, veçanërisht për grupet më vulnerabël brenda komunitetit LGBTI+. Në mënyrë të veçantë, 90% e personave transgjinerë deklarojnë se nuk kanë akses në shërbime afirmuese të gjinisë brenda vendit, çka ilustron mungesën pothuajse të plotë të këtij shërbimi në sistemin shëndetësor publik.

Mungesa e besimit te profesionistët e shëndetësisë dhe frika nga trajtimi diskriminues në ambientet e institucioneve shëndetësore ndikojnë drejtpërdrejt në qasjen e përfituesve ndaj shërbimeve shëndetësore. Rreth 25% e të anketuarve raportojnë se shmangin vizitat në shërbimet e shëndetit seksual dhe riprodhues, ndërsa 14% kanë përjetuar forma të drejtpërdrejta diskriminimi nga personeli shëndetësor.

Këto barriera reflektohen në mënyrë të veçantë te gratë lezbike dhe biseksuale, ku vetëm 19% raportojnë se kanë kryer një vizitë gjinekologjike gjatë vitit të fundit, ndërsa mbi 28%

deklarojnë se e kanë shmangur në mënyrë të vetëdijshme këtë shërbim, pavarësisht nevojës për të.

Në tërësi, këto gjetje tregojnë se, përtej ekzistencës formale të shërbimeve shëndetësore, faktorë si mungesa e shërbimeve të specializuara, frika nga diskriminimi dhe mungesa e besimit në sistem vazhdojnë të kufizojnë aksesin real dhe efektiv të personave LGBTI+ në kujdesin shëndetësor.

10.3 Aksesin në Punësim dhe Strehimi

Të dhënat nga pyetësorët me anëtarët e komunitetit, tregojnë se aksesin në punësim dhe strehim mbetet i pasigurt dhe i shoqëruar me nivele të larta informaliteti dhe diskriminimi. Një pjesë e konsiderueshme e personave LGBTI+ raportojnë përjashtim nga tregu formal i punës, ku 47% deklarojnë se punojnë në mënyrë informale, ndërsa 30% rezultojnë të papunë. Për më tepër, 27% e të anketuarve raportojnë përvoja të drejtpërdrejta të ngacmimit ose diskriminimit në kontekstin e punësimit.

Mjedisi i punës perceptohet në mënyrë të gjerë si i pasigurt dhe jo gjithëpërfshirës. Rreth 76% e të anketuarve deklarojnë se nuk ndihen të sigurt në vendin e punës, ndërsa 88% raportojnë se nuk kanë dalë hapur për orientimin seksual apo identitetin gjinor, për shkak të frikës nga pasojat negative, përfshirë humbjen e vendit të punës ose trajtimin diskriminues.

Në lidhje me strehimin, aksesin në programet publike mbetet minimal, me vetëm 4% të përfituesve që raportojnë se kanë përfituar nga skemat e strehimit social. Paralelisht, 17% e të anketuarve raportojnë se kanë përjetuar diskriminim gjatë përpjekjeve për të siguruar një banesë me qira, duke reflektuar barrierat e vazhdueshme në tregun privat të strehimit.

Në tërësi, këto gjetje tregojnë se përjashtimi nga tregu formal i punës, mungesa e sigurisë në vendin e punës dhe barrierat në aksesin në strehim krijojnë një situatë të ndërthurur vulnerabiliteti, e cila ndikon drejtpërdrejt në stabilitetin ekonomik dhe mirëqenien e personave LGBTI+.

10.4 Emigrimi (tregues i përgjithshëm)

Të dhënat e mbledhura nga pyetësorët me anëtarët e komunitetit LGBTI+, tregojnë një prirje të theksuar drejt emigrimit, e cila përbën një nga treguesit më domethënës të ndikimit kumulativ të boshllëqeve institucionale. Rreth 88% e të anketuarve deklarojnë se kanë

konsideruar seriozisht largimin nga vendi, një rritje e ndjeshme krahasuar me 65% në periudhën 2020-2024.

Arsyet e raportuara për këtë prirje janë të ndërlidhura dhe reflektojnë mangësi strukturore në mbrojtjen dhe garantimin e të drejtave. Konkretisht, 74% e lidhin vendimin për emigrim me mungesën e njohjes ligjore, 48% me përvojat e diskriminimit, ndërsa 30% me pasigurinë ekonomike.

Në tërësi, kjo tendencë përfaqëson një tregues sintetik të ndikimit të politikave publike, duke reflektuar jo vetëm mungesën e progresit në disa fusha kyçe, por edhe perceptimin e përhapur se kushtet për jetesë të barabartë dhe të sigurt për personat LGBTI+ mbeten të pamjaftueshme në Shqipëri.

10.5 PËRFUNDIME

Analiza e perspektivës së komunitetit LGBTI+ evidenton një mospërputhje të theksuar ndërmjet zbatimit formal të Planit Kombëtar të Veprimit dhe ndikimit real të tij në jetën e përditshme të përfituesve fundorë. Ndërkohë që një pjesë e institucioneve raportojnë aktivitete dhe ndërhyrje të caktuara në zbatim të logjikës ndërhyrëse të Planit, të dhënat nga komuniteti tregojnë se këto masa nuk janë përkthyer në përmirësim të dukshëm të aksesit në të drejta, shërbime dhe mbrojtje efektive.

Në shumicën e treguesve kryesorë evidentohet një drejtim përkeqësimi (↓), përfshirë diskriminimin në shëndetësi dhe punësim, pasigurinë në strehim, si dhe nivelin e lartë të mos-raportimit të rasteve të diskriminimit dhe krimeve të urrejtjes. Këto të dhëna sugjerojnë se ndërhyrjet e parashikuara në kuadër të Planit nuk kanë arritur të adresojnë në mënyrë efektive barrierat strukturore që përjeton komuniteti.

Veçanërisht shqetësues mbetet fakti që aksesit i barabartë në shërbime themelore, si kujdesi shëndetësor, punësimi dhe strehimi, vazhdon të kufizohet nga faktorë si mungesa e shërbimeve të specializuara, frika nga diskriminimi dhe mungesa e besimit në institucionet publike. Këto elemente ndikojnë drejtpërdrejt në përjashtimin social dhe ekonomik të personave LGBTI+, duke krijuar një cikël të vazhdueshëm vulnerabiliteti.

Treguesi i qëllimit për emigrim përforcon këtë analizë, duke reflektuar një nivel të lartë mosbesimi ndaj mundësisë për të ndërtuar një jetë të sigurt dhe të barabartë në vend. Rritja e ndjeshme e përqindjes së personave që konsiderojnë largimin nga Shqipëria tregon se

boshllëqet në njohjen ligjore, mbrojtjen nga diskriminimi dhe sigurinë ekonomike nuk perceptohen si të përkohshme, por si strukturore dhe të qëndrueshme.

Në tërësi, perspektiva e komunitetit konfirmon se sfida kryesore nuk qëndron vetëm në mungesën e zbatimit të disa masave specifike, por në pamundësinë e sistemit për të prodhuar ndryshim real dhe të matshëm në jetën e përfituesve. Kjo qasje, vendos në qendër të analizës nevojën për një rishikim të thelluar të mënyrës së zbatimit të Planit, me fokus në efektivitet, llogaridhënie dhe ndikim konkret të masave të planifikuara.

11. KONKLUSIONE TË MONITORIMIT

Ky raport monitorimi ofron një vlerësim të strukturuar dhe të bazuar në prova mbi nivelin e zbatimit të Planit Kombëtar të Veprimit për Personat LGBTI+ 2021-2027, për periudhën 2021-2025. Gjetjet e analizës konfirmojnë se, pavarësisht ekzistencës së një kornize strategjike të avancuar dhe të harmonizuar me standardet ndërkombëtare, zbatimi në praktikë mbetet i pjesshëm, i fragmentuar dhe i pabarabartë ndërmjet sektorëve dhe niveleve të qeverisjes.

Në nivel institucional, progresi i dokumentueshëm është i kufizuar dhe i përqendruar në disa institucione specifike, si Shkolla e Magjistraturës, Avokati i Popullit, Univeristeti i Mjekësisë dhe në një masë të caktuar Ministria e Turizmit, Kulturës dhe Sportit. Megjithatë, ky progres nuk përfaqëson një qasje sistemike dhe të qëndrueshme, por më tepër ndërhyrje të izoluara, të cilat në shumë raste mbështeten në kontributin e organizatave të shoqërisë civile dhe partnerëve ndërkombëtarë.

Një nga konstatimet më të rëndësishme të këtij raporti është se hendeku kryesor nuk qëndron vetëm në moszbatimin e masave të parashikuara, por në mungesën e kapaciteteve institucionale për të raportuar dhe monitoruar zbatimin në përputhje me logjikën e Aneksit 4. Mungesa e të dhënave të strukturuar, indikatorëve të matshëm dhe dokumentacionit verifikues e bën të vështirë vlerësimin përfundimtar të progresit, çka në vetvete, përbën një tregues të funksionimit të dobët të mekanizmave të zbatimit.

Në aspektin sektorial, një pjesë e konsiderueshme e produkteve kryesore të Planit mbeten të pazbatuara ose të paprovuara si të realizuara. Këtu përfshihet sidomos:

- ! Mungesa e protokolleve të miratuara shëndetësore për personat transgjinjorë;
- ! Mungesa e moduleve të formalizuara në sistemin arsimor dhe universitar,

- ! Mosfeksionimi i pikave fokale në institucionet kyçe,
- ! Mungesa e sistemeve të qëndrueshme të mbledhjes dhe raportimit të të dhënave;
- ! Mungesa e informacionit mbi burimet buxhetore të përdorura dhe të planifikuara;
- ! Mungesa e njohjes së plotë ligjore të personave LGBTI+ në Shqipëri.

Në nivel vendor, situata paraqitet veçanërisht problematike. Mungesa e përgjigjes nga mbi 83% e bashkive dhe mungesa e plotë e buxheteve të dedikuara për zbatimin e PKV-së në nivel vendor, dëshmojnë për një nivel të ulët të prioritizimit të kësaj politike publike, si dhe për mungesë të mekanizmave efektive të llogaridhënies dhe koordinimit vertikal.

Një dimension kritik i këtij raportimi lidhet me perspektivën e vetë komunitetit LGBTI+ lidhur me zbatimin e Planit. Kjo perspektivë eidenton një përkeqësim të një sërë treguesish kyç, përfshirë diskriminimin në shëndetësi dhe punësim, pasigurinë në strehim dhe nivelin e ulët të raportimit të shkeljeve të të drejtave, rasteve të krimeve të urrejtjes dhe diskriminimit. Në këtë kuptim, të dhënat tregojnë se ndërhyrjet institucionale të deritanishme, nuk kanë arritur të prodhojnë përmirësime të prekshme në jetën e përditshme të përfituesve.

Treguesi i qëllimit për emigrim përbën një sintezë të qartë të këtyre mangësive strukturore. Rritja e ndjeshme e përqindjes së personave që konsiderojnë largimin nga vendi (65%-88%) reflekton mungesën e besimit të këtyre qytetarëve në mundësinë për të jetuar në kushte të barabarta dhe të sigurta në Shqipëri, si dhe ndikimin kumulativ të boshllëqeve në njohjen ligjore, mbrojtjen nga diskriminimi dhe sigurinë ekonomike.

Në tërësi, ky raport konfirmon se sfidat kryesore të zbatimit të PKV-së mbeten strukturore dhe të vazhdueshme, duke reflektuar një vijimësi të problematikave të identifikuara edhe nga monitorimi i zbatimit të Planit pararendës 2016-2020. Për këtë arsye, periudha e mbetur e zbatimit të PKV-së, 2026-2027, përbën një moment kritik për riorientimin e politikave dhe ndërhyrjeve institucionale, me fokus në:

- ! Operacionalizimin real të masave të parashikuara;
- ! Sigurimin e financimit të dedikuar dhe të qëndrueshëm;
- ! Forcimin e mekanizmave të monitorimit dhe raportimit; dhe
- ! Garantimin e një ndikimi të matshëm të masave të zbatuara në jetën e personave LGBTI+.

Pa një ndërhyrje të tillë të strukturuar dhe të orientuar drejt rezultateve të prekshme, ekziston rreziku që Plani Kombëtar i Veprimit të mbetet një instrument formal politikash, pa efekt real dhe transformues në praktikë.

12. REKOMANDIME

Rekomandimet e mëposhtme synojnë adresimin e boshllëqeve strukturore të evidentuara gjatë monitorimit të zbatimit të PKV-së dhe orientimin e ndërhyrjeve prioritare për periudhën e mbetur të zbatimit të këtij dokumenti strategjik, 2026-2027.

Rekomandimet janë strukturuar sipas aktorëve përgjegjës dhe nivelit të urgjencës, me fokus në kalimin nga ndërhyrjet me karakter deklarativ, në zbatim të matshëm dhe të verifikueshëm të logjikës ndërhyrëse.

12.1 Institucionalizimi i zbatimit të PKV-së dhe llogaridhënia

- Ministria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale duhet të përfundojë pa vonesë rishikimin dhe miratimin e standardeve specifike për tre llojet e shërbimeve mbështetëse (masa I.1.2.a), duke siguruar prodhimin e produktit formal dhe zbatimin e tij në praktikë.
- Ministria e Punëve të Brendshme dhe Policia e Shtetit Shqiptar duhet të emërojnë dhe të bëjnë plotësisht funksionale 61 pikat fokale LGBTI+, duke përfshirë trajnimin e tyre dhe integrimin në mekanizmat e raportimit dhe trajtimit të rasteve (masat II.2.2.a-b), brenda vitit 2026.
- Të gjitha ministritë e linjës dhe njësitë e vetëqeverisjes vendore duhet të miratojnë dhe zbatojnë politika të brendshme kundër diskriminimit që përfshijnë në mënyrë eksplicite mbrojtjen e personave LGBTI+ (masat III.2.1.d-e).
- Ministria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale duhet të vendosë në funksion mekanizmin e raportimit vjetor të zbatimit të PKV-së në përputhje me matricën e Aneksit 4 (masa II.2.4), duke e bërë raportimin të detyrueshëm, të standardizuar dhe të verifikueshëm për të gjitha institucionet.

12.2 Shëndetësia

- Operatori i Shërbimit të Kujdesit Shëndetësor dhe njësitë vendore të kujdesit shëndetësor duhet të fillojnë menjëherë zbatimin e programit të trajnimit të

përvitshëm për 360 profesionistë të kujdesit shëndetësor parësor (masa I.3.1.b), duke rikuperuar vonesën e akumuluar.

- Ministria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale duhet të përfundojë miratimin dhe të sigurojë zbatimin efektiv të Protokollit mjekësor për personat transgjinjorë, si dhe të nisë menjëherë trajnimet e parashikuara për profesionistët (masat I.3.2.a-b).
- Duhet të vendoset një sistem funksional për mbledhjen e të dhënave shëndetësore të ndara sipas orientimit seksual dhe identitetit gjinor, në përputhje me standardet e mbrojtjes së të dhënave personale.

12.3 Niveli vendor

- Ministria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale duhet të zhvillojë një program të strukturuar orientimi dhe asistence teknike për të gjitha bashkitë, mbi detyrimet konkrete të Aneksit 4 dhe standardet e raportimit.
- Njësitë e vetëqeverisjes vendore duhet të integrojnë zbatimin e PKV-së në planet vjetore të punës dhe dokumentet strategjike lokale, duke alokuar burime financiare të dedikuara.
- Duhet të vendoset një mekanizëm i detyrueshëm raportimi për bashkitë, i lidhur me mekanizmat e monitorimit qendror.

12.4 Arsimit dhe ngritja e kapaciteteve të profesionistëve

- Institucionet e arsimit të lartë duhet të formalizojnë modulet mbi çështjet LGBTI+ si pjesë e kurrikulave të miratuara, me përmbajtje të strukturuar, rezultate të matshme dhe mekanizma vlerësimi (masat I.2.2.a-f).
- Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin Parauniversitar duhet të përfundojë dhe të akreditojë modulën e trajnimit për profesionistët e arsimit parauniversitar dhe të nisë zbatimin e tij në nivel kombëtar (masa I.2.1.a).
- Duhet të sigurohet integrimi sistematik i çështjeve të diversitetit dhe mosdiskriminimit në formimin fillestar dhe të vazhdueshëm të profesionistëve të drejtësisë, policisë dhe shëndetësisë.

12.5 Të dhënat, monitorimi dhe transparenca

- Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi dhe Policia e Shtetit duhet të vendosin një sistem të rregullt dhe të standardizuar për mbledhjen dhe publikimin vjetor të të

dhënave mbi diskriminimin dhe krimet e urrejtjes ndaj personave LGBTI+ (masa II.2.1.a).

- Të gjitha institucionet përgjegjëse duhet të adoptojnë formatin e raportimit të bazuar në treguesit dhe rezultatet e Aneksit 4, duke kaluar nga raportimi narrativ në raportim të matshëm të zbatimit.
- Duhet të zhvillohet një sistem i unifikuar ndërinstytucional për mbledhjen, analizën dhe shkëmbimin e të dhënave relevante mbi zbatimin e PKV-së.

12.6 Njohja ligjore dhe kuadri normativ

- Ministria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale dhe Ministria e Drejtësisë duhet të finalizojnë dhe paraqesin për miratim projektligjin për njohjen ligjore të identitetit gjinor (masa II.1.3.a), duke përmbushur detyrimet e vonuara në kuptim të Planit.
- Ministria e Drejtësisë duhet të përshpejtojë analizën dhe procesin e ndryshimeve në Kodin e Familjes dhe aktet e lidhura, duke e trajtuar këtë ndërhyrje si prioritet të menjëhershëm dhe jo afatmesëm.
- Duhet të sigurohet që kuadri ligjor të jetë në përputhje me standardet evropiane dhe ndërkombëtare në fushën e të drejtave të njeriut, veçanërisht në lidhje me njohjen ligjore dhe mbrojtjen efektive nga diskriminimi të personave LGBTI+.

BURIME DHE REFERENCA

Akte ndërkombëtare dhe dokumente të organizatave ndërkombëtare

1. Komiteti për Eliminimin e Diskriminimit ndaj Grave (CEDAW) (2023). *Concluding Observations on the Fourth Periodic Report of Albania*. Komiteti CEDAW, OKB.
2. Komiteti për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore (CESCR) (2023). *Concluding Observations on the Combined Second to Fourth Periodic Reports of Albania*. Komiteti CESCR, OKB.
3. Këshilli i të Drejtave të Njeriut i OKB-së (2024). *Raporti i Grupit të Punës mbi Rishikimin Periodik Universal (UPR): Shqipëria*. Gjenevë: OKB.
4. Komisioni Evropian (2022-2025). *Raportet e Progresit për Shqipërinë*. Bruksel: Komisioni Evropian.
5. ILGA-Europe (2022-2025). *Annual Review of the Human Rights Situation of Lesbian, Gay, Bisexual, Trans and Intersex People in Europe and Central Asia - Albania*. Bruksel: ILGA-Europe.
6. ECRI - Komisioni Evropian kundër Racizmit dhe Intolerancës (2020). *Raporti për Shqipërinë - Cikli i Gjashtë i Monitorimit*. Strasburg: Këshilli i Evropës.
7. Komisioneri për të Drejtat e Njeriut, Këshilli i Evropës (2011). *Discrimination on Grounds of Sexual Orientation and Gender Identity in Europe - Second Edition*. Strasburg: Këshilli i Evropës.
8. Këshilli i Evropës (2018). *Safe at School: Education Sector Responses to Violence Based on Sexual Orientation, Gender Identity/Expression or Sex Characteristics in Europe*. Strasburg: Këshilli i Evropës.
9. International Labour Standards Department (2019). *Information Paper on Protection against Sexual Orientation, Gender Identity and Expression, and Sexual Characteristics (SOGIESC) Discrimination*. Organizatës Ndërkombëtare të Punës (ILO).
10. ERA - LGBTI Equal Rights Association (2018). *Report on Legal Gender Recognition in the Western Balkans and Turkey*.
11. UNDP Albania (2017). *Të Jesh LGBTI në Evropën Lindore: Raporti për Shqipërinë*. Tiranë: UNDP.
12. World Bank Group (2018). *Life on the Margins: Survey Results of LGBTI People in Southeastern Europe*. Washington DC: World Bank.
13. Strategjia e Bashkimit Evropian "Union of Equality: LGBTIQ Equality Strategy 2020-2025". Bruksel: Komisioni Evropian.
14. Strategjia e Bashkimit Evropian "Union of Equality: LGBTIQ Equality Strategy 2026-2030". Bruksel: Komisioni Evropian.

Akte ligjore dhe dokumente strategjike kombëtare

17. Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë.
18. Ligji nr. 10221, datë 04.02.2010, "Për Mbrojtjen nga Diskriminimi", i ndryshuar.
19. Ligji nr. 22/2018, datë 03.05.2018, "Për Strehimin Social".
20. Ligji nr. 111/2017, datë 14.12.2017, "Për Ndihmën Juridike të Garantuar nga Shteti".
21. Ligji nr. 10/2021, datë 01.02.2021, "Për Azilin në Republikën e Shqipërisë".
22. Ligji nr. 79/2017, datë 27.04.2017, "Për Sportin", i ndryshuar.
23. Ligji nr. 10107, datë 30.03.2009, "Për Kujdesin Shëndetësor në Republikën e Shqipërisë".
24. Ligji nr. 8876, datë 04.04.2002, "Për Shëndetin Riprodhues".

25. Ligji nr. 15/2016, datë 10.03.2016, "Për Parandalimin dhe Luftimin e Infeksioneve dhe Sëmundjeve Infektive".
26. Ligji nr. 7961, datë 12.07.1995, "Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar.
27. Ligji nr. 9062, datë 08.05.2003, "Kodi i Familjes i Republikës së Shqipërisë".
28. Ligji nr. 7895, datë 27.01.1995, "Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar.
29. Ligji nr. 69/2012, datë 21.06.2012, "Për Sistemin Arsimit Parauniversitar në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar.
30. Ligji nr. 18/2017, datë 16.02.2017, "Për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës".
31. Ligji nr. 23/2018, datë 10.05.2018, "Për Mbrojtjen Sociale".
32. Ligji nr. 10129, datë 11.05.2009, "Për Gjendjen Civile", i ndryshuar.
33. Ligji nr. 64/2025, datë 15.05.2025, "Për Barazinë Gjinore".
34. Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 390, datë 25.05.2016, "Për miratimin e Planit Kombëtar të Veprimit për Personat LGBTI 2016-2020". Fletorja Zyrtare nr. 97/2016.
35. Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 700, datë 18.11.2021, "Për miratimin e Planit Kombëtar të Veprimit për Personat LGBTI+ 2021-2027".

Raporte, studime dhe dokumente monitorimi

36. Aleanca Kundër Diskriminimit LGBT (2021). *Raporti Vjetor mbi Situatën e Komunitetit LGBTI+ në Shqipëri*. Tiranë.
37. Aleanca Kundër Diskriminimit LGBT (2022). *Raporti Vjetor mbi Situatën e Komunitetit LGBTI+ në Shqipëri*. Tiranë.
38. Aleanca Kundër Diskriminimit LGBT (2023). *Raporti Vjetor mbi Situatën e Komunitetit LGBTI+ në Shqipëri*. Tiranë.
39. Aleanca Kundër Diskriminimit LGBT (2024). *Raporti Vjetor mbi Situatën e Komunitetit LGBTI+ në Shqipëri*. Tiranë.
40. Aleanca Kundër Diskriminimit LGBT (2025). *Raporti Vjetor mbi Situatën e Komunitetit LGBTI+ në Shqipëri*. Tiranë.
41. Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi (2021-2025). *Raporte Vjetore*. Tiranë.
42. Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale (2018). *Raport Monitorimi mbi Zbatimin e Planit Kombëtar të Veprimit për Personat LGBTI 2016-2020*. Tiranë.
43. Pyetësori kombëtar me komunitetin LGBTI+ (2021-2025), realizuar nga Aleanca Kundër Diskriminimit LGBT me persona LGBTI+ në Shqipëri.
44. Reporter.al (2023). "Gjuha e Kodit Penal shqiptar ruan stigmën rreth homoseksualitetit".
45. Nini, D. (2020). *SDGs Implementation in the Context of Albania*.

Autore: Ma. Sanela Lilaj; Av. LL.M Dea Nini



ALEANCA LGBTI



AGORA



**Financuar nga
Bashkimi Evropian**



Gender Alliance for Development Center
Qendra Aleanca Gjinore për Zhvillim



TFL
TOGETHER FOR LIFE



IRCA
INSTITUTE OF ROMANI CULTURE IN ALBANIA

Aleanca Kundër Diskriminimit LGBT | Maj 2026

Ky botim u prodhua me mbështetjen financiare të Bashkimit Evropian. Përmbajtja e tij është përgjegjësi e vetme e autorit dhe nuk pasqyron domosdoshmërisht pikëpamjet e Bashkimit Evropian.